



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office of Good Governance

Raporti për zbatim të
Planit të VEPRIMIT për [Strategjinë Qeveritare për](#)
[Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023](#)

[Periudha e vlerësimit 2022](#)

[2023](#)

Lista e Shkurtesave

ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM/ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit
OSHC	Organizatata e Shoqërisë Civile
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizatata Jo-Qeveritare
AT	Asistencë Teknike
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje
2. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË
3. PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT:
 1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë bërje;
 2. Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OShC-ve në interes publik;
 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike; si dhe
 4. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik.
4. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE
5. SHTOJCA I: Vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit qeveri- shoqëri civile mund të bëhet vetëm përmes përmirësimit të shërbimeve të cilat e ofrojnë ekzekutivin me qytetarët e Republikës së Kosovës dhe shoqërinë civile.

Për ta përmirësuar dhe arritur këtë zhvillim, në Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, qeveria bashkë me shoqërinë civile kanë vendosur katër objektiva strategjike për periudhën e zbatimit:

1. **Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë bërje;**
2. **Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik;**
3. **Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike; si dhe**
4. **Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik.**

Një shoqëri civile aktive e fuqizuar konsiderohet një komponent thelbësor i demokracive moderne pluraliste. Prandaj, zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike është thelbësor në zhvillimin e qeverisjes gjithëpërfshirëse, të orientuar nga qytetarët dhe respektimin e diversitetit në të gjitha aspektet e shoqërisë.

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dhënë prioritet bashkëpunimit me shoqërinë civile, forcimit të dialogut me organizatat e shoqërisë civile me përfshirje të plotë si dhe pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e politikave dhe legjisllacionit.

Gjatë kësaj kohe si partnerë, institucionet me organizatat e shoqërisë civile kanë qenë të fokusuar në avancimin e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile përmes përmirësimit dhe zbatimit të shumicës së objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në strategjinë dhe planin e veprimit tre vjeçar. Si partnerë këto vite janë vazhdimësi e zbatimit të standardeve minimale për konsultimin publik, transparencës në financimin publik të OJQ-ve e edhe zbatimit të shumë projekteve të përbashkëta për përmirësimin e këtij bashkëpunimi. Ne si institucione bashkë me organizatat e shoqërisë civile kemi punuar për avancimin e procesit, veçanërisht duke përmirësuar përfshirjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në politikë bërjen dhe hartimin e legjisllacionit.

Të arriturat dhe sfidat e bashkëpunimit qeveri –shoqëri civile janë identifikuar e vlerësuar edhe te raporti i progresit (raporti për vendin). Sipas raportit për vendin, shoqëria civile në përgjithësi në Republikën e Kosovës vazhdon të funksionojë në një mjedis të favorshëm. Mirëpo shoqëria civile dhe qeveria duhet të vazhdojnë të përmirësojnë më tej bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe të rrisin aftësinë e shoqërisë civile për të kontribuar në mënyrë kuptimplotë në zhvillimin e politikave publike. Edhe më tej nevojiten përpjekjet për të rritur transparencën e financimit publik për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të). Po sipas këtij raporti edhe gjatë pandemisë, shoqëria civile në Kosovë ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm, veçanërisht në nivelin lokal. Organizatat e shoqërisë civile vazhdojnë të mbështesin drejtpërdrejt zhvillimin dhe zbatimin e reformave të ndërlidhura me BE-në. Për të vazhduar me konsultimet publike për aktet e qeverisë të cilat sipas raportit vazhdojnë të lansohen rregullisht nga ministritë.

Raporti i fundit vjetor i qeverisë për konsultimet publike tregon se është arritur të avancohet Platforma për Konsultimet Publike (<https://konsultimet.rks-gov.net>) duke shtuar funksionalitete të reja dhe duke përmirësuar qasjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile për të marrë pjesë në proceset konsultative në lidhje me dokumentet e hartuara nga institucionet. Në këtë raport është dhënë një pasqyrë të qartë të performancës së institucioneve për përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në politike bërje. Mirëpo sipas këtij raporti disa ministri ende nuk po organizojnë konsultime në përputhje me rregulloren përkatëse.

Në nivel lokal edhe komunat janë integruar në Platformën e përgjithshme Online për konsultime publike, por zbatimi është ende në fazat e para. Mirëpo, raporti thekson nevojën për iniciativa vetëdijesimi për të inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë në proceset e konsultimit në nivelin qendror dhe atë lokal.

Financimi publik për shoqërinë civile vazhdon të raportohet çdo vit dhe të bëhet i qasshëm për publikun. Informatat bazë rreth autoriteteve financuese, organizatave përfutuese dhe shumës së fondeve të ndara duhet të plotësohen me të dhëna për projektet dhe sektorët. Në vitin 2023 duhet të

iniciohet një rishikim i rregullores aktuale të financimit publik të OJQ-ve, për të adresuar pengesat kryesore të identifikuara gjatë tre viteve të para të zbatimit të saj. Tash nga MFPT është themeluar ekipi bazë për të filluar rishikimin e rregullores.

Duhet të përmirësohet mjedisi i favorshëm për vullnetarizëm, përmes vendosjes së një kornize të përshtatshme të përafuar me standardet ndërkombëtare.

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dhënë prioritet bashkëpunimit me shoqërinë civile, forcimit të dialogut me organizatat e shoqërisë civile me gjithë përfshirje, pjesëmarrje të saj në zhvillim të politikave dhe legjislacionit dhe jo vetëm, por edhe në identifikim të prioriteteve dhe sfidave në të mirë të zhvillimit të shoqërisë në Kosovë. Është rritur niveli i bashkëpunimit me organizata Jo-qeveritare, forume, koalicionë të OJQ-ve etj., që punojnë direkt me grupe të ndjeshëm të shoqërisë dhe mund të veçojmë edhe shembujt konkret, si koalicioni për mbrojtjen e fëmijëve, forumi i personave me aftësi të kufizuara, rrejtja e grupeve të grave, etj. dhe të njëjtën kohë është një përfaqësimi dhe pjesëmarrje shumë më e madhe e përfaqësuesve të shoqërisë civile në mekanizmat institucional në fushëveprime të ndryshme.

Është shumë me rëndësi që të theksohet se është fuqizuar struktura e përgjithshme për bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, pra Qeveria e Republikës së Kosovës bashkë me Civikos-in dhe koordinatorët e ekipeve të punës të Këshillit e ka fuqizuar Këshillin për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile.

Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile është mekanizmi kryesor i përhershëm i cili koordinon të gjithë procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Në përbërje të këtij Këshilli janë edhe katër Ekipe të Punës, që e ndihmojnë punën operacionale të tij. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ishte shumë pro aktive në të gjitha segmentet e koordinimit të punës së Këshillit dhe zbatimit të objektivave strategjike. Gjatë kësaj kohës si bashkë partner institucionet me organizatat e Shoqërisë civile janë fokusuar në avancimin e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile përmes përmirësimit dhe zbatimit të shumicës së objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në strategji e plan të veprimit. Viti 2022 paraqet vazhdimësi të zbatimit të standardeve minimale për konsultimet me publikun, transparencës në financimin publik të OJQ-ve dhe realizimit të shumë projekteve të përbashkëta në përmirësim të këtij bashkëpunimi.

Është punuar në avancimin e procesit, veçanërisht përmes përmirësimit të përfshirjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në politikë bërje dhe hartim legjislacioni. Kemi arritur të avancojmë Platformën për Konsultimet me Publikun (<https://konsultimet.rks-gov.net>) duke shtuar funksionalitete të reja dhe duke e përmirësuar qasjen për qytetarët dhe shoqërinë civile për pjesëmarrje në proceset konsultative në lidhje me dokumentet që hartohen nga institucionet qendrore dhe lokale. Kemi ofruar pasqyrë të qartë të performancës së institucioneve për përfshirje të qytetarëve dhe shoqërisë civile në politikë bërje.

Procesi i raportimit për financimin e OJQ-ve është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke e krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke e mundësuar edhe raportimin direkt në platformën për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net>. Ky proces është avancuar në vazhdimësi, ku është krijuar dhe lansuar platforma <http://ojqfinancime.rks-gov.net>; e cila siguron transparencë më të madhe në shpenzimin e parasë publike për projektet dhe programet e OJQ-ve.

Mirëpo platforma e lansuar gjatë vitit 2020, është avancuar në vitin 2022 dhe tani po mundëson që të gjitha organizatat buxhetore të raportojnë drejtpërdrejtë përmes saj, duke ngarkuar të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin paraprak. Për vitin 2022 do të realizohet transparencë e plotë e shpenzimeve të buxhetit për sektorin e shoqërisë civile duke ofruar të gjitha të dhënat e procesit të shpenzimit të parasë publike për OJQ-të. Është punuar dhe arritur që raporti për vitin 2022 të përgatitet dhe publikohet direkt në platformë, pra pothuajse të gjitha organizatat buxhetore po raportojnë drejtpërdrejtë përmes platformës, duke ngarkuar të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve që i kanë përkrahur direkt në platformë sipas avancimit që është arritur. Pra, Platformën ekzistuese për Financimin Publik të Organizatave të Shoqërisë Civile në Kosovë, me ekspert të angazhuar nga TACSO-s e kemi përmirësuar dhe avancuar për të ndihmuar të gjitha palët e interesuara në këtë proces. Ky avancim kryesisht përkrahë ministritë dhe komunat në Republikën e Kosovës për raportimin me të lehtë të financimit publik të projekteve dhe programeve të OShC-ve në përputhje me rregullat dhe kërkesat e parashikuara në Rregulloren MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat për

financimin publik për OJQ-të e në të njëjtën kohë publikun të cilit i mundëson pasqyrim dhe transparencë për fondet që institucionet i ndajnë për OJQ-të.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka dhënë dhe vazhdon të jap një kontribut të vazhdueshëm në avancimin e transparencës dhe llogaridhënies në ofrimin e mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Kontributi i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit duhet parë edhe përtej këtij raporti, në veçanti në ofrimin e mbështetjes për zyrtarët publik si dhe për OJQ-të, përmes përkrahjes së zyrtarëve përgjegjës të institucioneve publike me qëllim të implementimit sa më të mirë të rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Ky raport është përgatitur bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit si dhe manualin për zbatimin e tij.

2. PËRPARMI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË

Strategjia për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile për periudhën 2019-2023 është miratuar nga Qeveria e Kosovës në shkurt të vitit 2019, si vazhdimësi e procesit të bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile dhe është strategjia e dytë qeveritare e cila është në fuqi edhe tani dhe përmban katër objektiva strategjike. Këto objektiva duhet të përmbushen përgjatë periudhës së paraparë për zbatimin e saj. Bashkë me Strategjinë është aprovuar Plani i Veprimit për Implementimin e Strategjisë për Periudhën 2019-2021 në të cilin janë përkufizuar objektivat specifike për secilën prej objektivave strategjike, aktivitetet, periudha kohore, kostoja e zbatimit të tyre, institucionet përgjegjëse për ndërmarrjen e tyre, si dhe detaje tjera relevante. Ashtu si në strategjinë e parë, fushat kryesore në të cilat janë arritur sukseset më të mëdha vazhdojnë të mbesin pjesëmarrja e shoqërisë civile në politikë-bërje, dhe financimi publik i organizatave të shoqërisë civile. Digjitalizimi i procesit të konsultimeve publike dhe financimit publik të OShC-ve nëpërmjet lansimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të platformave elektronike kanë ndikuar në rritjen e zbatimit të dy objektivave të para të Strategjisë. Në anën tjetër, zbatimi i kësaj Strategjie është përcjellë vazhdimisht me sfida të cilat ndikojnë në punën e institucioneve dhe rrjedhimisht rezultojnë në mos realizimin e objektivave të saj.

Objektivat e Strategjisë 2019-2023 janë vendosur në bazë të konsultimeve me shoqërinë civile duke i marrë parasysh rezultatet e vlerësimit për strategjinë e mëparshme si dhe prioritetet e vendosura në dokumentet përkatëse të Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë është siguruar përmbushja dhe vazhdimësia e objektivave dhe masave të planifikuara në dokumentet e tjera strategjike përkatëse të qeverisë, gjegjësisht në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Strategjinë Kombëtare për zhvillim 2016-2021, Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2017-2021, Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Bashkërendimit të Politikave në Kosovë 2017-2021.

Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023 përmban katër objektiva strategjike, si në vijim:

- 1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje;**
- 2. Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OShC-ve në interes publik;**
- 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;**
- 4. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik.**

Mekanizmi kryesor që e koordinon procesin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile është Këshilli për bashkëpunimin Qeveri-Shoqëri Civile, i cili është themeluar në korrik të vitit 2019. Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë, me një shumicë prej 15 përfaqësuesve nga OShC-të dhe 14 përfaqësues nga institucionet shtetërore. Institucioni kryesor për mbështetjen e punës së Këshillit është Zyra për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM), e cila po ashtu bashkë me institucionet përgjegjëse është edhe sekretariat për raportimin e zbatimit të Strategjisë.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me CiviKosin-in dhe koordinatoret e ekipeve të punës ka koordinuar punën e Këshillit për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile gjatë gjithë

kësaj kohe. ZQM/ZKM për Këshillin ka ndarë raporte e informacione për aktivitetet që janë realizuar e veçanërisht publikim e raporteve vjetore për fushat që i mbulon strategjia.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit z. Arben Krasniqi dhe znj. Donika Emini, Drejtoreshë Ekzekutive e Platformës CiviKos, me qëllim të koordinimit për zhvillimet, progresin dhe sfidat e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile sidomos gjatë periudhës së raportimit kanë realizuar takime të përbashkët pune.

Gjithashtu ZQM/ZKM në cilësi të Sekretariatit të Këshillit për bashkëpunim të qeverisë me shoqëri civile, përgjegjës për monitorim të zbatimit të aktiviteteve për objektivat strategjike dhe planin vjetor të Këshillit ka realizuar me CiviKos-in, koordinatorët e ekipeve dhe me ekipet e punës takime.

Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile zbatohet në linjë me Planin e Veprimit 2019-2021. Mirëpo nga ana e Këshillit plani i viti 2021 është bartur për vitin 2022, pasur parasysh që aktivitetet e parapara për këtë kohë kanë mbetur të pazbatuara, pra, gjithmonë në koordinim me Këshillin dhe Zyrën për Planifikim Strategjik si përgjegjës për monitorim janë bartur për vitin 2022.

Strategjia i ka: katër objektiva strategjike, 14 objektiva specifike, 33 tregues dhe 48 veprime të ndryshme. Më poshtë në këtë raport, është paraqitur përparimi i zbatimit të Strategjisë/Planit të Veprimit për 2019-22. Janë përdorur të gjitha të dhënat në dispozicion nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ministritë, komunat dhe institucionet e tjera të mbledhura përmes ueb faqeve dhe komunikimeve të drejtpërdrejta me e-mail.

Gjatë kohës së raportimit, niveli i zbatimit është si në vijim:

Objektiva Strategjike I "Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje"

Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, në këtë objektiv strategjik priten dy të arritura kryesore:

- Përmirësimi i përfshirjes së OSHC-ve në fazat fillestare të hartimit të legjislacionit dhe politikave;
- Rritja e kontributit të OSHC-ve në bërjen e politikave.

Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:

- Numri i OSHC-ve të përfshira në grupet punuese për hartimin e politikave të reja dhe fazave të hershme të zhvillimit të legjislacionit, me më së paku 50 OSHC kurse synimi është 150 OSHC.

Treguesi i dytë në këtë nivel ndërlihet me:

- Numrin e OSHC-ve që kontribuojnë në konsultimet e hapura publike për draft politikave, ku deri në fund të vitit 2021 synohet përfshirja e 350 OSHC-ve

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si koordinator e procesit të konsultimeve me publikun në bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës përmes koordinatorëve për konsultime në ministritë e linjës të përfshirë në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit, ka punuar në zbatim të standardeve për konsultimet me publikun. Rrjedhimisht është punuar në monitorimin dhe raportimin e procesit të konsultimeve me publikun. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me koordinatorët kanë vazhduar të ofrojnë me kapacitetet e tyre maksimale hapësirë publikut për tu përfshirë në procesin e konsultimit publik.

Përmes platformës online, Zyra për Qeverisje të Mirë së bashku me ministritë kanë arritur të publikojnë dhe ndajnë me publikun dokumentet e planifikuara për t'u hartuar dhe përcjellë vazhdimisht edhe për miratim nga qeveria dhe ministritë. Gjatë gjithë kohës është duke punuar në ofrimin e një pasqyrimi për zbatimin e kriterëve të parapara për gjithë përfshirje në përputhej me Rregulloren nr.05/2016 për standardet minimale për konsultime me publikun.

Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit, ka avancuar modalitetet në platformën për konsultime dhe përmes platformës, uebfaqes dhe rrjeteve sociale, ka zhvilluar dhe po zhvillon fushatë informuese për Platformën Online për Konsultimet Publike dhe Standardet Minimale për përfshirjen e qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Është përgatitur një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultimet Publike (tutorial) i cili u bën thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që të përdorin Platformën Online për konsultime publike. Ky tutorial gjithashtu edhe

e shpjegon se si shoqëria civile dhe publiku mund të përfshihen në platformë dhe të komentojnë direkt në platformë.

Në platformën online për konsultimet me publikun është punuar në përditësimin e të dhënave për institucionet e edhe për koordinatorët përgjatë gjithë kohës, korrigjimin e platformës dhe mirëmbajtjen e saj me të dhëna të reja.

Monitorimi i zbatimit të procesit të konsultimeve është përveç që është pjesë e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, ishte edhe pjesë e vlerësimit të Komisionit Evropian përmes marrëveshjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për mbështetjen direkte buxhetore.

Përveç shtrirjes në nivel qendror të qeverisë, sistemi i konsultimeve publike është zgjeruar edhe në të gjitha komunat si në aspektin rregullator ashtu edhe në krijimin e mjeteve dhe kushteve për zbatimin e tij d.m.th. të gjitha komunat janë pjesë e integruar e platformës për konsultimet me publikun. Mirëpo duhet theksuar se niveli lokal nuk është pjesë e fushëveprimit të këtij raporti edhe këtë vit, sepse janë vetëm një pjesë e komunave që kanë filluar të publikojnë dokumente për konsultimet me publikun në platformën për konsultime dhe emërimi i koordinatorëve për konsultime në nivelin lokal është ende në proces. Gjithashtu monitorimi dhe raportimi i procesit të konsultimeve me publikun për nivelin lokal është përgjegjësi e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si koordinatore e procesit të konsultimeve me publikun në bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës përmes koordinatorëve për konsultime në ministritë e linjës të përfshirë në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit, ka punuar në zbatim të standardeve për konsultimet me publikun. Kemi ofruar pasqyrë të qartë të performancës së institucioneve për përfshirje të qytetarëve dhe shoqërisë civile në politikë bërje.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 Qeveria e Republikës së Kosovës ka finalizuar konsultimin për 247 dokumente të cilat hyjnë në kategorinë e dokumenteve që sipas Rregullores hartuesit e tyre e kanë për obligim ti konsultojnë me publikun. Nga këto dokumente 247 kanë qenë të publikuara në platformën e konsultimeve.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë ka punuar në përmirësimin e funksionalitet të përgjithshëm të Platformës Online për konsultimet me publikun, me theks të veçantë në qasjen e personave me aftësi të kufizuara te kjo platformë. Patjetërsueshëm që kjo do të ndikoj në përmirësimin e gjithë përfshirjes duke u mundësuar personave të shurdhër dhe atyre të verbër për tu qasur dhe mundësi për të kontribuar në bërjen e politikave dhe legjislacionit. Konsultimet e rregullta dhe gjithëpërfshirëse mes Qeverisë dhe publikut, e sidomos me personat me aftësi të kufizuara janë faktorët kyç për t'iu mundësuar edhe personave me aftësi të kufizuara pjesëmarrjen e plotë në proceset shoqërore në Kosovë dhe dhënien e kontributit të tyre në zhvillimin e politikave. Me anë të këtij procesi gjithëpërfshirës të konsultimit publik, të gjithë pa përjashtim do të marrin pjesë aktive dhe do ta japin kontributin e tyre për të mirën e përgjithshme.

Permbledhje e llojeve te dokumenteve te publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjate periudhes (qe jane mbyllur										
Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprim it	Draft rregullor e	Udhëzim administrati v	Strategji	Progra m	Tjeter	Totali	Ne perqindje ne raport me te gjitha IRK-te
Zyra e Kryeministrit	2	1	0	1	1	4	3	0	12	4.86%
Rinise dhe Sportit	3	3	0	13	1	0	0	1	21	8.50%
Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktures	2	6	0	0	21	4	0	1	34	13.77%
Ndermarresise dhe Tregtise	0	5	0	4	15	1	0	0	25	10.12%
Admistrimit të Pushtetit Lokal	3	0	1	0	2	1	0	0	7	2.83%
Ministria e Mbrojtjes	0	4	0	12	0	0	0	0	16	6.48%
Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve	1	4	1	1	9	1	0	0	17	6.88%
Ministria e Shendetesise	1	2	0	0	7	0	0	1	11	4.45%
Pylltarise dhe Zhvillimit Rural	6	2	0	0	19	0	1	0	28	11.34%
Ministria e Ekonomise	3	1	0	12	3	1	1	0	21	8.50%
Ministria e Drejtesise	4	9	1	0	9	1	0	1	25	10.12%
Komunitete	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Brendshme	0	5	1	3	4	2	0	0	15	6.07%
Shkences, Teknologjise dhe Inovacionit	0	3	0	1	8	1	0	0	13	5.26%
Ministria e Puneve te Jashtme dhe Diaspores	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Rajonal	0	1	0	0	1	0	0	0	2	0.81%
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Totali	25	46	4	47	100	16	5	4	247	
Ne perqindje	10.12%	18.62%	1.62%	19.03%	40.49%	6.48%	2.02%	1.62%		

Plotësimi i kriterëve të treguesve të SBS-it – gjithashtu në raport vlen të përmendet edhe Marrëveshja për Mbështetjen Direkte Buxhetore në kuadër të IPA për treguesin II “Komunikimi efektiv me publikun, konsultimi publik dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara”. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë dhe me përkrahje të koordinatorëve në ministritë e linjës ka arritur ta përmbushin këtë indikator. Kjo marrëveshje ka përcaktuar detyrime shtesë ku sipas kësaj marrëveshje konkretisht treguesi II, në vitin 2021 të paktën 75% e draft strategjive, politikave/programeve, koncept dokumentet dhe ligjet parësore të miratuara nga qeveria është duhet t'i nënshtrohen konsultimit publik në përputhje me Rregulloren për Standardet Minimale për Konsultimin Publik. Pra, vlerësimi për treguesit e SBS-it për plotësim të indikatorit II për konsultimet me publikun për vitin 2021 ka qenë 75%. Vlen të përmendim se në kuadër të kornizës së kushteve të treguesit të SBS-it gjatë vitit 2021 janë konsultuar gjithsejtë 110 dokumente. Prej tyre 77,27% i kanë plotësuar standardet ndërsa 22,73% nuk i kanë plotësuar standardet.

Komentet direkt në platformën online - Numri i komenteve që kemi pranuar direkt në platformë gjatë vitit 2022 është 274 komente ku janë 50 dokumente janë të komentuar, ndërsa 198 nuk kanë komente. Duke e parë se po jetojmë në një shoqëri të transformuar nga teknologjia Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë kemi punuar dhe kemi prezantuar para publikut videon promovuese për qasje në platformën për konsultime me publikun edhe për personat me aftësi të kufizuara <https://konsultimet.rks-gov.net>

Plotësimi i standardeve – Prej të gjitha dokumenteve të publikuara në platformë, pra prej 248 dokumenteve, 180 prej tyre ose 72.5% i plotësojnë standardet dhe 67 dokumente ose 27.5% prej tyre nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun.

1. Përqindja e konsultave publike për të cilat janë dhënë raportet finale (qendrore)




Figura 1: Shkalla e plotësimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2022

Permbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2022-31.12.2022				
Institucioni	Me raport final	Pa raport final	Totali	Ne përqindje ne raportin (Me raport / Pa raport)
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktues	27	7	34	79.41%
Ministria e Industrise, Ndermarresise dhe Tregtise	24	1	25	96.00%
Ministria e Kultures Rinise dhe Sportit	21	0	21	100.00%
Ministria e Bujqesise Pylltarise dhe Zhvillimit Rural	20	8	28	71.43%
Ministria e Ekonomise	17	4	21	80.95%
Ministria e Mbrojtjes	16	0	16	100.00%
Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve	14	3	17	82.35%
Ministria e Arsimit, Shkences, Teknologjise dhe Inovacionit	13	0	13	100.00%
Ministria e Drejtesise	12	13	25	48.00%
Ministria e Adminsitrimt të Pushtetit Lokal	7	0	7	100.00%
Zyra e Kryeministrit	6	6	12	50.00%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	2	0	2	100.00%
Ministria e Shendetesise	1	10	11	9.09%
Ministria e Inovacionit dhe Ndermarresise [deri me 03.02.2020]	0	0	0	0.00%
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor [deri me 03.02.2020]	0	0	0	0.00%
Ministria e Integrimt Evropian [deri me 03.06.2020]	0	0	0	0.00%
Ministria e Puneve te Jashtme dhe Diaspores	0	0	0	0.00%
Ministria e Diaspores [deri me 03.02.2020]	0	0	0	0.00%
Ministria e Puneve te Brendshme	0	15	15	0.00%
Ministria per Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0.00%
Ministria e Administrates Publike [deri me 03.02.2020]	0	0	0	0.00%
Ministria e Punes dhe Mireqenies Sociale [deri me 22.03.2021]	0	0	0	0.00%
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0.00%
Totali	180	67	247	
Ne përqindje	72.87%	27.13%		

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ka lansuar “Kornizën për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet me publikun për periudhën 2021 – 2025”. Nga kjo kornizë janë nxjerrë rekomandime se si institucionet duhet të përmirësojnë zbatimin e standardeve minimale për gjithë përfshirje të publikut në punën e saj.

Krahas përparimit të madh të arritur në këtë objektiv strategjik, disa sfida të cilat duhet të adresohen në të ardhmen janë:

- Përmirësimi i funksionaliteteve të përgjithshme të platformës online për konsultime publike/ Raportimi direkt në platformë/ Pra angazhim i ekspertëve për të zhvilluar specifikat teknike për përmirësimin e funksionaliteteve të përgjithshme të platformës Online e të cilat duhet të diskutohen dhe përmirësohen bashkë me OSHC-të (anëtarët e Këshillit dhe rrjetet e OJQ-ve të OSHC-ve për aftësinë e kufizuar)
- Ndarja e informatave për dokumentet në platformë të standardizohet edhe përmes rrjeteve të sociale/Hapja e llogarive të veçanta të rrjeteve sociale të platformës online për konsultime publike të menaxhuara nga ZQM/ZKM
- Realizimi i sesioneve trajnuese për zyrtarët përgjegjës për mënyrën e përdorimit të funksionaliteteve të reja të Platformës, e sidomos tash ata në nivelin lokal
- Përmirësimi i qasjes në platformën online për personat me aftësi të kufizuara.

Objektiva e dytë e Strategjisë “Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik”

Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, në këtë objektiv strategjik pritet një rezultat:

- Thirrje publike në pajtim të plotë me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financim Publik të OSHC-ve.

Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:

- Përqindja e institucioneve që bëjnë thirrje publike për financimin e OSHC-ve në përputhje me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve. Synimi i përkohshëm është 75% e të gjitha institucioneve të zhvillojnë thirrje publike për financimin e OSHC-ve në linjë me Rregulloren.

Përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërtuar një sistem me rregulla unike sa i përket financimit publik të OJQ-ve, rregulla këto të cilat përcaktojnë kriteret minimale të ndërlidhura me financimin publik të OJQ-ve. Rregullorja MF-Nr. 04/2017 krahas obligimeve tjera përcakton në mënyrë të detajuar përgjegjësinë që institucionet publike kanë për raportimin lidhur me financimin publik të OJQ-ve. Rregullorja synon unifikimin e procedurave për gjithë ciklin e financimit publik të OJQ-ve, duke përfshirë, planifikimin, thirrjet publike, kontraktimin, monitorimin dhe raportimin e këtij financimi.

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të zbatimit të rregullave dhe procedurave të financimit Publik të Organizatave Joqeveritare që i përcakton Rregullorja e MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, bashkë me ministrinë e linjës dhe komunat e Republikës së Kosovës ka vazhduar me publikimin, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të financimit Publik të OJQ-ve.

Që nga raporti i parë i vitit 2015-2016, kur mungonin rregullat unike sa i përket kriterëve, standardeve dhe procedurave të financimit publik të OJQ-ve e deri në vitin 2022, vërehet një përmirësim cilësor si në aspektin e vendosjes së kornizës ligjore, e po ashtu edhe në zbatimin e saj në praktikë. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit në vazhdimësi është duke punuar me institucionet publike, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të zbatuar në mënyrën e duhur, kornizën ligjore që rregullon këtë fushë.

Publikimi i Raporteve Vjetore të mbështetjes financiare publike për OJQ-të ka marrë vlerësime pozitive nga të gjitha institucionet, shoqëria civile por edhe nga Raporti i Komisionit Evropian, duke e konsideruar si një hap pozitiv drejt një transparence më të madhe të financimit publik të OJQ-ve.

Tashmë vërehet një praktikë e mirë e krijuar në të gjitha organizatat buxhetore për të hapur thirrje publike për financimin e projekteve të OJQ-ve. Mund të vërehet një avancim në aplikimin dhe zbatimin e rregullores sa i përket financimit publik të OJQ-ve. Institucionet kanë publikuar thirrjet publike në ueb faqet e tyre në shumicën e rasteve, dhe të njëjtat janë të qasshme online.




Figura 3. Të dhëna të përgjithshme sa i përket raportimit nga organizatat buxhetore

Gjithashtu, ndonëse rregullorja është e qartë në kërkesat e saja, disa nga organizatat buxhetore edhe pse kanë publikuar thirrje publike, të njëjtat nuk kanë qenë plotësisht në linjë me kërkesat e rregullores, ose nuk kanë qenë mjaft të qarta dhe të ndërlidhura me prioritetet e institucioneve të definuara në dokumentet strategjike.

Raporti mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të për vitin 2022, përfshinë informacione mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të, ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë dhe Komunat për përkrahjen e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fusha të ndryshme, të ndërlidhura me prioritetet e Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe shoqërisë kosovare. Raporti mbulon të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal të cilat në çfarëdo forme kanë ofruar mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare.

Procesi i raportimit për financimin e OJQ-ve është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke e krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke e mundësuar edhe raportimin direkt në platformën për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net>

Gjatë kësaj kohe kemi punuar në avancim të platformës, ku me një kërkim të lehtë në platformën online mund të gjinden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OShC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, regjioneve, fushave etj. Ky proces është avancuar në vazhdimësi, pra prej kur është krijuar dhe lansuar platforma <http://ojqfinancime.rks-gov.net> e cila ka mundësuar dhe po mundëson që të rritet transparencja në financimin e projekteve të OJQ-ve, jo vetëm duke publikuar më shumë të dhëna për projektet e financuara nga ana e autoriteteve publike por edhe duke u monitoruar nga ana e publikut, OJQ-ve dhe institucioneve përgjegjëse.

Publikimi i raportit gjithëpërfshirës për mbështetjen financiare publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës edhe për vitin 2022 tashmë është bërë një praktikë e vazhdueshme e Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitet e fundit.

Kjo patjetër që po kontribuon në rritjen e besimit të publikut në institucionet publike dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu kjo besojmë se do të frymëzoj qytetarët që të bëhen edhe më aktiv dhe të kontribuojnë në dobi të komunitetit. Edhe në këtë kohë të raportimit ashtu si edhe e

kemi cekur më lart kemi punuar në avancim të platformës, ku me një kërkim të lehtë në platformën online mund të gjinden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OShC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, etj. Për herë të parë këtë vit është realizuar pothuaj transparencën e plotë të shpenzimeve të buxhetit për sektorin e shoqërisë civile duke ofruar të gjitha të dhënat e procesit të shpenzimit të parasë publike për OJQ-të.

Gjatë kësaj kohe Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerrë rekomandimet për transparencë institucionale dhe të cilat ne si institucione obligohemi dhe duhet të i zbatojmë në linjë të Rregullores MF-Nr. 4/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve dhe legjislacionit në fuqi.

Rekomandimet e Kuvendit janë miratuar në seancën plenare të mbajtur me 04 tetor 2021, pasi Kuvendi i ka shqyrtuar rekomandimet e dala nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në lidhje me raportin e auditimit të performances “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare” për disa institucione.

Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit, ne si koordinator të procesit krahas rekomandimeve të kuvendit kemi iniciuar dhe krijuar mekanizmin për planifikim dhe raportim institucional për financim publik për OJQ-të. Gjatë vitit 2022 ne si koordinator të procesit kemi forcuar këtë mekanizëm të përhershëm i cili po ndihmon punën dhe po koordinon planifikimin dhe raportimin vjetor për financimin e organizatave jo-qeveritare në kuadër të secilës ministri dhe komunë.

Zyrtarët përgjegjës për këtë proces janë caktuar nga të gjitha ministrinë, nga zyrat përgjegjëse në Zyra e Kryeministrit që ndajnë fonde për OJQ-të si dhe 33 komunat përgjegjëse, ndërsa pesë komuna tani për tani janë jashtë funksionit institucional.

Këto pika kontakti po bëjnë tashmë koordinim shumë më të mirë të procesit të planifikimit dhe raportimit vjetor lidhur me fondet publike të alokuara për secilën organizatë joqeveritare nga organizata buxhetore në Republikën e Kosovës. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me ekspert të TACSO-s ka krijuar llogaritë për secilin zyrtarë përgjegjës në ministri dhe komuna për qasje në Platformën e Financimeve publike për raportim dhe plotësim të tabelave direkt në platformë.

Në mënyrë që ta lehtësojmë punën e pikave të kontaktit për raportim ne i kemi përgatitur edhe manualin dhe videot përkrasë ku janë përshkruar identifikimi dhe orientimi në platforme, futja e të dhënave të raportimit dhe importimi i të dhënave. Manuali i përgatitur ka shpjeguar dhe sqaron mundësitë dhe hapat në detaje se si ta përdorim platformën për të raportuar për përkrasjen financiare për OShC-të direkt në platformën <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>.

Raporti vjetor mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të, përfshinë informacione mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të, ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe Komunitatet për përkrasjen e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fusha të ndryshme për vitin 2022, të ndërlidhura me prioritetet e Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe publikut. Raporti mbulon të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal të cilat në çfarëdo forme kanë ofruar mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare.

Si rekomandim i raporteve vjetore për financim publik të OJQ-ve dhe si aktivitet i planifikuar të plani i veprimit për strategjinë ka qenë gjithashtu edhe “Rritja e rolit mbikëqyrës të MFPT në zbatimin e Rregullores” konkretisht qarkullimi i një qarkore nga ministria për ta ndihmuar zbatimin e rregullores. Rrjedhimisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka ndarë Qarkoren për Organizatat Buxhetore rreth zbatimit të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Sipas qarkores me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje është vendosur një sistem transparent dhe llogaridhënës për financimin publik të programeve dhe projekteve të shoqërisë civile që janë të interesit publik në Republikën e Kosovës, si dhe janë unifikuar rregullat për financimin publik të OJQ-ve për të gjitha organizatat buxhetore. Gjithsesi edhe përkundër faktit se që nga hyrja në fuqi e Rregullores, dispozitat e së njëjtës kanë gjetur zbatim tek organizatat buxhetore, është vlerësim i vazhdueshëm në raporte të publikuara qeveritare për mbështetjen financiare publike për OJQ-të se përpjekje plotësuese për zbatimin e Rregullores nga organizatat buxhetore janë të nevojshme. Rrjedhimisht, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka lëshuar qarkoren si një shkresë sqaruese për zbatim uniform të dispozitave dhe procedurave të parapara në Rregullore, e në veçanti vë theksin tek disa dispozita që duhet të gjejnë më tej zbatim në praktikë.

Sipas Raportit janë rreth 86% e institucioneve që kanë raportuar, ku prej tyre 66% e institucioneve kanë raportuar direkt në platformë, 20% e institucioneve kanë raportuar se nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare dhe 14 % nuk kanë raportuar për fondet që janë ndarë për OJQ-të.

Publikimi i këtij raporti ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, duke mundësuar krijimin e besimit të ndërsjellë në mes të institucioneve dhe shoqërisë civile, e që do të vazhdohet edhe përmes të avancimit edhe më tej të kësaj platforme.

Sa i përket raportimit dhe publikimit të informatave lidhur me financimin publik të OJQ-ve për vitin 2022 nga ana e Organizatave Buxhetore, kemi përmirësim shumë të dukshëm të gjendjes, sepse ky raport gjithëpërfshirës është shumë më i kompletuar sa i përket të gjitha procedurave të ndarjes së fondeve publike duke filluar nga planifikimi, thirrja e deri të raportimi direkt në platformë i organizatave buxhetore për fondet publike që i kanë ndarë për OJQ-të. Janë të gjitha Ministritë dhe zyrat në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që kanë raportuar direkt në platformën online për ndarjen e fondeve për OJQ-të, pa i llogaritur në detaje lëshimet teknike ose raportet jo të kompletuara për këtë ndarje fondesh, mirëpo është përmirësim i progresit dukshëm në këtë aspekt. Gjithashtu janë 30 komuna të cilat kanë raportuar po ashtu direkt në platformë për fondet që i kanë ndarë për OJQ-të. Janë pesë Komuna të minoriteteve që janë jashtë funksionit institucional (Zvecani, Parteshi, Shtërpca, Mitrovica e Veriut dhe Zubin Potoku) dhe tri komuna që nuk kanë raportuar (Deçani, Peja dhe Gjlani) për fondet publike që i kanë ndarë për OJQ-të.

Si rrjedhojë edhe këtë vit, Zyra për Qeverisje të Mirë, me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut lidhur me mbështetjen financiare publike për Organizatat jo Qeveritare, edhe këtë vit ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, gjegjësisht me Thesarin. Kjo është bërë në mënyrë që të përgatitet një raport sa më korrekt dhe gjithëpërfshirës bazuar në pagesat që organizatat buxhetore kanë ekzekutuar për përfituesit të cilët janë regjistruar në Thesar si Organizata Jo-Qeveritare. Publikimi i këtij raporti vlerësojmë se do të kontribuojë rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike dhe në të njëjtën kohë do të ketë ndikim në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile në Republikën e Kosovës. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka punuar dhe i ka përkrahur shumë zyrtarët nga shumë Institucione Qeveritare/Organizata Buxhetore për të ju ndihmuar dhe forcuar kapacitetet e tyre në implementimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Platforma e Financimit Publik iu nënshtrua një përmirësimi për të mundësuar raportimin hierarkik me shumë përdorues për financimin publik të OShC-ve nga të gjitha Ministritë/Agjencitë/Komunat e Kosovës dhe nën njësite e tyre përkatëse. Platforma e Financimit Publik tani lehtëson raportimin e financimit publik me futjen e dyfishtë të të dhënave, p.sh. përmes raportimit të drejtpërdrejtë në platformën e secilit prej projekteve të financuara nga institucionet publike, ose raportimit masiv duke u mundësuar organeve publike të mbledhin të dhëna nga të gjitha nën njësitë dhe të importojnë të dhënat përmes modulit të importit të platformës.

Në anën e qasjes nga publiku të platformës, ka veçori të reja të filtrimit të të dhënave, si dhe grafikët ndërveprues që vizualizojnë të dhënat dhe ndihmojnë publikun të ketë një perceptim se si shpenzohen paratë publike nga secili prej institucioneve, përfituesit e OShC-ve, territoret ku janë shpenzuar para dhe fushat dhe aktivitetet e përgjithshme të projekteve. Gjithashtu përmirësim dhe avancim tjetër në këtë platformë që është realizuar bashkë me projektin TACSO është edhe lidhja në mes të Platformës së financimit publik të OJQ-ve dhe platformës së Donatoreve, tashmë e përfunduar ku i gjithë publiku mund të shohin fondet që ndahen nga të gjithë donatorët për OJQ-të në Republikën e Kosovës. Zbatimi i plotë i ndryshimeve dhe reformave në platformë është arritur gjatë vitit 2022.

Publikimi i Raporteve Vjetore të mbështetjes financiare publike për OJQ-të ka marrë vlerësime pozitive nga të gjitha institucionet, nga vetë shoqëria civile por edhe nga Raporti i Komisionit Evropian, duke e konsideruar si një hap pozitiv drejt një transparence më të madhe të financimit publik të OJQ-ve.

Objektiva e III “Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike”

Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, në këtë objektivi strategjik pritet një rezultat:

- Rritja e numrit të OSHC-ve të kontraktuara në ofrimin e shërbimeve publike përmes thirrjeve/tenderëve të hapur publik.

Treguesi i synuar për këtë rezultat është:

- Numri i OSHC-ve të kontraktuara në ofrimin e shërbimeve publike përmes thirrjeve/tenderëve të hapur publik.

Objektiva e III është ndër objektivat që ka pasur më së paku progres në zbatim. Kjo si rrjedhojë e asaj se të gjitha aktivitetet janë të ndërlidhura duke filluar me hartimin dhe ndryshimin e bazës ligjore e cila është ende në fazën fillestare dhe deri te zbatimi i saj. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka punuar dhe po punon bashkë me CiviKos-in në krijimin e bazës së të dhënave për të gjitha OSHC-të që ofrojnë shërbime. Gjithashtu CiviKos-i bashkë me partnerë e OJQ-të tjera është në fazën e vlerësimit të nevojave të organizatave që ofrojnë shërbime. Kjo po bëhet në kuadër të projektit “Mitigating the impact of the COVID-19 pandemic on CSOs providing services mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, financuar nga German Marshall Fund -USAID. Per vlerësim të nevojave të ministrive CiviKos ka përkrahur Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ZQM/ZKM dhe institucionet tjera për finalizim të vlerësimit nga ana e institucioneve.

Sidoqoftë, çështja e shërbimeve publike duhet të zhvillohet në të ardhmen. Aktualisht MFPT njihet si institucion që i mbështet OSHC-të në ofrimin e shërbimeve. Pika e nisjes, krahas nevojës për përmirësimin e mëtejme të legjislacionit, duhet të jetë krijimi i bazës së të dhënave për OSHC-të të cilat janë ofruese të shërbimeve. Kjo praktikë është krijuar kryesisht në kuadër të MFPT , MSH por prapë siç edhe është theksuar në këtë objektivë nevojiten përmirësime në legjislacion që duhet t’i rregullojnë standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve, si dhe për ngritjen e vetëdijes së institucioneve për modelet më të mira për kontraktimin e OSHC-ve.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Shëndetësisë posedojnë listat e tyre për OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale. Po ashtu ish MPMS , tanimë Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, disponon dhe ka në dispozicion listën e OJQ-ve të licencuara për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel vendi. Numri i OJQ-ve të licencuara ka arritur në 49 OJQ. Për të theksuar se edhe CiviKos është në proces të grumbullimit të dhënave për OSHC-te që ofrojnë shërbime.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka qenë pjesë e shumë aktiviteteve ku vlen të përmendet aktivitetit që Fondi për Zhvillim Komunitar – CDF, në kuadër të Programit të financuar nga granti i Fondit Global që kanë iniciuar diskutimin dhe procesin e krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të financimit publik të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), për të ofruar shërbime shëndetësore parandaluese të bazuara në komunitet, në kuadër të Programeve kombëtare për HIV dhe TB.

MFPT me përkrahje të CiviKos-it e bashkëpunim të ZQM/ZKM dhe ekspertëve të fushës së kontraktimit të shërbimeve kanë përgatitur një dokument të politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-së. Në Republikën e Kosovës në vitet e fundit janë zhvilluar me dhjetëra projekte të përafërta ku institucionet publike, në një formë, kanë bërë kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të. Por në mungesë të një akti ligjor dhe procedure të qartë, janë shfrytëzuar procedura të ndryshme të kontraktimit, kryesisht nëpërmjet kontraktimit sipas Rregullore MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (Rregullore Nr. 04/2017) apo akteve të institucioneve me procedura të ngjashme, përjashtimisht edhe me kontraktimin e drejtpërdrejtë.

Në këtë dokument të politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-së, është bërë identifikimi dhe analiza e infrastrukturës aktuale ligjore në Republikën e Kosovë që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndërlidhen me kontraktimin e shërbimeve në mes të institucioneve publike dhe OJQ-ve. Dispozitat ligjore të prezantuara në pjesën e dytë të këtij dokumenti të politikave dëshmojnë për ekzistimin e një baze ligjore solide për kontraktimin e shërbimeve me OSHC, por edhe të kriterëve dhe procedurave për lidhjen e marrëveshjeve të kontraktimit.

Gjithashtu në kë dokument më pastaj, janë dhënë rekomandimet konkrete lidhur me veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me hartimin e një akti ligjor lidhur me kontraktimin e shërbimeve. Në fund, është dhënë edhe një kornizë të detajuar për përmbajtën e aktit nënligjor.

Objektiva e IV “Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik“

Objektivi Specifik: Vendosja e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale për të mbështetur zhvillimin e vullnetarizmit .

Ekipi i Punës, bashkë me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit dhe MKRS janë në finalizim të koncept dokumentit për Vullnetarizëm. Rol kyç në drejtim të përmbylljes dhe përcjellës së këtij dokumenti për aprovim në qeveri ka Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

ZQM/ZKM dhe MKRS bashkë me ekipin e punës kanë realizuar takime pune dhe shumë shpejt do të paraqesim dhe prezantojmë draftin për konsultime paraprak dhe publik. Ky dokument përfshinë tri propozime për rregullimin e vullnetarizmit, mirëpo sipas rregullave propozimi që është përkrahur nga diskutimet me grupin dhe të gjithë partnerët është krijimi i një mekanizmi institucional që do të koordinoj të gjitha përpjekjet e institucioneve përkatëse dhe organizatave për zhvillimin e vullnetarizmit në Kosovë. Roli i këtij mekanizmi do të jetë promovimi, nxitja, avokimi dhe zhvillimi i përgjithshëm i vullnetarizmit në Kosovë. Ky trup gjithëpërfshirës, do të përbëhet nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, ekspertët, akademikët dhe përfaqësuesit e Ministrive të ndryshme. Realizimi i aktiviteteve të radhës në këtë objektivë patjetër që është i ndërlidhur me aprovimin e koncept dokumentit në qeveri.

Rreziqet/Sfidat dhe masat lehtësuese

Edhe ky raport rrjedhimisht thekson nevojën për përmirësimin e kapaciteteve institucionale për të qenë në pajtim me kërkesat e reja, duke cekur se disa ministri dhe komuna ende nuk janë gati për t'i përmbushur obligimet e tyre sipas Rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi. Ende ka mungesë të kapaciteteve teknike për ekzekutimin efektiv të buxhetit të ndarë në pajtim me rregullat dhe procedurat e vendosura.

Sfidat që duhet të vazhdohet të mbesin të veçuara janë:

- Shkalla e plotësimin të standardeve minimale për konsultimet me publikun, megjithëse ka pasur rritje ndër vite, në vitin 2022 rreth 71 % prapë paraqet sfidë, e sidomos hartimi dhe publikimi i raportit të konsultimit me kohë, pra po e ulë përqindjen e zbatimit të standardeve në disa ministri.
- Ndërimi i koordinatorëve, bashkimi i ministrive është paraqitur si sfidë në vitin 2021/22.
- Rritja e numrit të komenteve të palëve të interesit në proces të konsultimit paraqet sfidë.
- Disa institucione publike nuk shpallin thirrje publike dhe nuk ofrojnë mbështetje financiare publike për OSHC-të siç e kërkon Rregullorja.
- Rregullorja për financim të OJQ-ve ka kërkesa të qarta, disa organizata buxhetore, ndonëse kanë shpallur thirrje publike, ato nuk kanë qenë tërësisht në përputhje me kërkesat e Rregullores.
- Praktikrat dhe procedurat më të mira për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike mbesin një sfidë e madhe për vitin 2022/23. Shumica e aktiviteteve dhe masave në këtë objektivë do të duhet të vazhdohet të mbesin të përfshira edhe për vitin e ardhshëm.
- Draft koncept dokumentit për vullnetarizëm ende nuk është finalizuar.
- Buxheti shtetëror i pamjaftueshëm për zbatimin e Strategjisë Qeveritare
- Ndarje e pamjaftueshme e burimeve financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatim dhe monitorim efektiv të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile;
- Përkushtimin afatgjatë i Qeverisë dhe Shoqërisë civile për të garantuar zbatimin e masave të Strategjisë për Bashkëpunim Qeveri me Shoqërinë Civile dhe të gjithë procesit.

Parandalimin e mos- zbatim të kësaj strategjie duhet ta fokusoj te:

- Një linjë e veçantë e buxhetit të parashihet për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.
- Qeveria dhe të gjitha institucionet përgjegjëse të ndajnë burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve për të cilat janë përgjegjës

- Angazhimi dhe ndarja e zyrtarëve përgjegjës aty ku është e mundur për të siguruar zbatimin dhe monitorimin efektiv të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile
- Një zyrtarë si zëvendës qoftë të koordinatorët për konsultimet publike e edhe te ata për raportim dhe planifikim të financimit publik të OJQ-ve, i cili do të jetë i informuar vazhdimisht për të gjitha aktivitetet.
- Të vazhdohet me trajnime/ngritje kapacitetesh për pikat e kontaktit/koordinatorët për financim për procedurat për raportim dhe planifikim për financimin publik të OJQ-ve nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave.
- Të vazhdohet me trajnime/ngritje kapacitetesh për anëtarët e Këshillit përfaqësues nga organizatat e Shoqërisë civile për mandatin, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre
- Të promovohet platforma për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net>

Përfundimet

Strategjia për Bashkëpunimin Qeveri Shoqëri Civile 2019-2023, u miratua në shkurt të vitit 2019, me Plan të detajuar të Veprimit për periudhën 2019-2021. Ky në vazhdimësi e edhe ashtu si edhe u cek më lartë është një dokument që e konfirmon përkushtimin e Qeverisë që të përmirësohet mjedisi përkrahës për zhvillimin e shoqërisë civile dhe krijimin e parakushteve për një bashkëpunim më efektiv të organeve qeveritare me OSHC-të në proceset e reformave kyçe në vend.

Katër objektivat specifike i pasqyrojnë prioritetet për një shoqëri civile aktive, OSHC të qëndrueshme, si dhe për të promovuar përmirësimin e bashkëpunimit. Plani I veprimit është vazhduar dhe aktivitetet e vitit 2021 janë shtyrë për zbatim në vitet e mbetura për Strategjinë. Këtë vit do të bëhet vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për të filluar me hartim të Strategjisë së re.

Strategjia është zbatuar përgjithësisht mirë, me disa vonesa të vogla dhe ku ka vend për përmirësim dhe zhvillim tutje të procesit. ZQM/ZKM-ja është duke i vënë shumicën e kapaciteteve dhe përpjekjeve në zbatimin e aktiviteve. Në total, në Strategji janë planifikuar 48 veprime, 17 prej të cilave janë për vitin 2019.

Prej të gjitha aktiviteve të planifikuara për vitet 2019-2021, pra prej 48 aktiviteve, 15 aktivitete nuk janë zbatuar, 14 prej tyre janë në zbatim e sipër dhe 19 aktivitete janë zbatuar tërësisht. Po ashtu, duhet të theksohet që shumica e aktiviteve që kanë qenë të planifikuara për objektivat dhe masat kanë avancuar dhe janë zhvilluar edhe më shumë se planifikimi në dokument.

Përparimi kryesor është arritur në Objektivin Specifik 1 dhe Objektivin Specifik 2. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante i ka finalizuar raportet vjetore për vitin 2021, 2022 në këto fusha por, përparim është arritur edhe në avancimin e platformave për konsultimet publike dhe asaj për financimin publik të OSHC-ve ndërtimin e kapaciteteve për shërbyesit civil përmes seancave trajnuese.

Disa praj arritjeve më të rëndësishme gjatë kohës së raportimit janë:

- Të gjitha politikat/strategjitë dhe dokumentet përcjellëse që janë hartuara (pothuajse 100%) janë konsultuar me publikun;
- Përqindja e përmbushjes së standardeve minimale për konsultime publike është rritur shumë;
- Është rritur numri i pjesëmarrësve në konsultime publike në krahasim me vitet paraprake;
- Është hartuar e aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës Raporti për mbështetjen financiare publike për OJQ-të për vitin 2022 për zbatim të Rregullores MF-Nr. 4/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve.
- Është bërë avancimi i platformës për Financimin publik të OJQ-ve e <http://ojqfinancime.rks-gov.net>; ku është punuar dhe arritur që raporti për vitin 2022 të përgatitet dhe publikohet direkt në platformë, pra të gjitha organizatat buxhetore kanë raportuar drejtpërdrejtë përmes platformës.
- Është hartuar e publikuar Raporti për konsultimet me publikun për vitin 2022.

- Është bërë avancimi i Platformës për Konsultimeve Publike <https://konsultimet.rks-gov.net>; duke shtuar funksionalitete të reja dhe duke përmirësuar qasjen për qytetarët dhe shoqërinë civile për pjesëmarrje në proceset konsultative në lidhje me dokumentet që hartohen nga institucionet qendrore dhe lokale.
- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores, MF-Nr. 04/2017, dhe rekomandimet e Kuvendit ka themeluar mekanizmin e përhershëm i cili do të koordinoj punën e planifikimit dhe raportimit vjetor për financimin e organizatave jo-qeveritare në kuadër të secilës ministri dhe komunë.
- Është hartuar “Raporti i hartëzimit të organizatave që ofrojnë Shërbime në Kosovë” dhe “Raportit të hartëzimit të legjislacionit për kontraktim të shërbimeve”
- Transferimi i praktikave nga niveli qendror në atë lokal është duke u bërë një prej arritjeve më domethënëse në zbatimin e Strategjisë.
- Është përgatitur një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultimet Publike (tutorial)
- Është bërë lansimi i "Kornizës për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimin publik për periudhën 2021 - 2025"
- Është hartuar raporti për përmirësimin e platformës elektronike për konsultime publike për qasjen për personat me aftësi të kufizuara.
- Është përgatitur Manuali për përdorimin e platformës online për financimin publik.

Shtojca

Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile zbatohet në linjë me Planin e Veprimit. Gjegjësisht, Strategjia i ka: katër objektiva strategjike, 14 objektiva specifike, 33 tregues dhe 48 veprime të ndryshme. Më poshtë në këtë raport, është paraqitur përparimi i zbatimit të Strategjisë/Planit të Veprimit për 2019-21.

Janë përdorur të gjitha të dhënat në dispozicion nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ministritë, komunat dhe institucionet e tjera të mbledhura përmes ueb faqeve dhe komunikimeve të drejtpërdrejta me e-mail.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE janë IV

- 15 OBJEKTIVA SPECIFIKE /
- 48 AKTIVITETE /
- 33 TREGUES

1. OBJEKTIVA STRATEGJIKE I

- 03 Objektiva Specifike
- 13 Aktivitetet

2. OBJEKTIVA STRATEGJIKE II

- 04 Objektiva Specifike
- 20 Aktivitetet

3. OBJEKTIVA STRATEGJIKE III

- 04 Objektiva Specifike
- 09 Aktivitetet

4. OBJEKTIVA STRATEGJIKE IV

- 04 Objektiva Specifike
- 06 Aktivitetet

- 09 Aktivitetet – kanë qenë të planifikuara për 2019
- 27 Aktivitetet – kanë qenë të planifikuara për 2020
- 12 Aktivitetet – kanë qenë të planifikuara për 2021

Përmbledhja e nivelit të zbatimit është si në vijim:

Objektivat Strategjike	Veprimet e planifikuara për vitin 2019-2021	Statusi i zbatimit të veprimeve në vitin 2019-2021
1. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në bërjen e politikave	13 aktivitete të planifikuara	të zbatuara (8 janë të zbatuara), në zbatim e sipër (4 janë në zbatim e sipër) të pa zbatuar (1 e pazbatuar)
2. Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik	20 aktivitetet të planifikuara	të zbatuara(10 janë të zbatuara) në zbatim e sipër(2 në zbatim e sipër) të pa zbatuar (8 të pazbatuara)
3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;	09 aktivitetet të planifikuara	të zbatuara (nuk ka të zbatuara) në zbatim e sipër (4 janë në zbatim e sipër) të pa zbatuar(5 të pazbatuara)
4. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik.	06 aktivitetet	të zbatuara(1 e zbatuar) në zbatim e sipër (4 në zbatim e sipër) të pa zbatuar(1 e pazbatuara)
Totali	48 aktivitete kanë qenë të planifikuara në total	- të zbatuara(19 të zbatuara) - në zbatim e sipër(14 në zbatim e sipër) - të pa zbatuara (15 të pazbatuara)

SHTOJCA 1 Vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

1	Objektivi Strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në bërjen e politikave								
1.1	Objektivi specifik: Përmirësimi i kapaciteteve të organeve shtetërore dhe komunave për përfshirjen e OShC-ve në hartimin e politikave								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	Progresi i zbatimit (Plotësohet nga Institucioni zbatues)
			2019	2020	2021				
1.1.1	Realizimi i sesioneve informuese mbi rregulloren për standardet minimale për konsultime publike	2020	1000	1000	1000	Buxheti i Kosovës, BE, SIDA	ZQM/ZKM/MAPL dhe IKAP	Të paktën 3 sesione informuese për Ministrinë dhe Komunitetet e zgjedhura të mbajtura Raporti i Trajnimit i Publikuar	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit kanë vazhduar bashkëpunimi me ministrinë, komunitet dhe shoqërinë civile sa i përket mbarëvajtjes dhe përmirësimit të procesit të konsultimeve publike. Nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë, ministrive dhe jo vetëm, por edhe Komunave, ju është ofruar mbështetje e vazhdueshme përmes informatave të përditshme, përgjigjeve dhe sqarime për institucionet. Në dhjetor 2020, ZQM/ZKM në bashkëpunim me IKAP kanë realizuar trajnim për shërbyes civilë nga niveli qendror e lokal për konsultimet me publikun dhe platformën online për përfshirje në e publikut në politikë bërje. Në këtë trajnim është prezantuar sistemi dhe metodologjia e konsultimeve me publikun, rregullorja, platforma dhe monitorimi e raportimi për rrjedhën e konsultimeve me

								<p>publikun. Pra janë certifikuar 10 Trajner për konsultimet me publikun.</p> <p>Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) bashkë me ekipin e Trajnerëve të certifikuar dhe ZQM/ZKM janë ftuar nëpunës të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal që të marrin pjesë në trajnimin online “Procesi i konsultimit me publikun”. Trajnimet janë organizuar për 2 (dy)grupe te pjesëmarrësve me datat 26 dhe 27 Prill 2021, edhe me datat 29 e 30 Prill 2021. Organizimin e trajnimeve online ka vazhduar me ToT e certifikuar edhe me data 17 dhe 18 Maj 2021 - Grupin e Parë dhe Grupin e dyte me datat 24 dhe 25 Maj 2021.</p> <p>Gjithashtu MAPL, konform mandatit të saj ligjor në vitin 2018 ka hartuar Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Standardet minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Me qëllim të informimit sa më të mirë të komunave, institucioneve ndër-ministore, organizatave të shoqërisë civile, mediat, si dhe akterëve të tjerë, MAPL ka zhvilluar konsultime publike me shkrim dhe në mënyrë elektronike. MAPL në bashkëpunim me partnerët (USAID) ka 5 sesione informuese me komunat dhe ministrinë, ku janë zyrtarët komunal janë informuar për obligimet dhe përgjegjësitë që kanë dalë nga ky udhëzim. Në vitin 2020, MAPL me qëllim të lehtësimit të procesit të zbatimit të këtij udhëzimi ka hartuar</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

										‘Manualin për standarde minimale të konsultimit publik’ i cili është përkrahur nga OSCE dhe pritet që të publikohet dhe të mbahet edhe sesione informuese të tjera me qëllim të promovimit të këtij manuali.
1.1.2	Vendosja e rregullave dhe standarde për konsultime publike në nivelin lokal	2019	2000	5000	6000	Buxheti i Kosovës, BE, SIDA	ZQM/ZKM MAPL/KIPA	Standardet dhe rregullat për konsultimet publike për nivelin lokal të miratuara dhe në funksionale	MAPL ka vendosur rregulla (standarde) të konsultimit publik në kuadër të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Standardet minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe përmes sesioneve informuese ka njoftuar zyrtarët komunal për obligimet dhe përgjegjësitë nga ky UA. Me rastin e publikimit të manualit për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, do të organizohen edhe sesione të tjera (trajnuese dhe informuese) me qëllim që zyrtarët komunal të kenë më të lehtë zbatimin e rregullave për konsultimeve publike në nivel lokal. ZQM/ZKM në bashkëpunim me MAPL ka kërkuar nga të gjitha komunat caktimin e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e Platformës për konsultimet me publikun dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet. Kjo është bërë në linjë të zotimeve tona të përbashkëta për respektimin e obligimeve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të	

									<p>Konsultimit Publik në Komuna, i nënshkruar nga Ministri i MAPL-së në dhjetor 2018. Kjo do të ndihmoj në respektimin e kornizës ligjore në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit.</p> <p>Zyra e Kryeministrit / Zyra e Qeverisjes së Mirë bashkë me Ministrinë e Pushteti Lokal do vazhdojë të organizojë takime të rregullta dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e standardeve minimale për konsultimet me publikun, por gjithashtu për të ndihmuar në tejkalimin e çdo sfide të mundshme që niveli lokal mund të kenë në lidhje me zbatimin e përditshëm të standardeve të miratuara.</p> <p>Deri tani janë caktuar 20 koordinatorë nga niveli lokal, ku disa nga koordinatorët në komunat vetëm se kanë filluar të publikojnë dokumente për konsultime me publikun në platformën online.</p>
1.1.3	Program Trajnimi për Institucionet Qeveritare mbi Metodatat e Përfshirjes së OShC-ve në politikë-bërje	2019/2020	6000	4000	2000	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM MAP		<p>Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike dhe me përkrahjen e projektit të AT të BE-së, gjatë 2020 kanë organizuar dhe ofruar Programin e trajnimit të trajnerëve (ToT) për konsultimet publike. Ky program është ofruar për zyrtarë të institucioneve publike dhe ka pasur synim të krijojnë një grup të trajnerëve që IKAP-i në të</p>

									ardhmen do ti angazhoj si trajner për ngritje kapacitetesh për zyrtarë tjerë në institucione publike në fushën e konsultimeve me publikun. Në shtator 2020, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike, pas procedurave të vlerësimit nga Komisioni, kanë organizuar ceremoni për ndarjen e certifikatave për ToT për konsultimet me publikun. Me këtë rast janë certifikuar 10 (dhjetë) Trajner për konsultimet me publikun.
1.1.4	Përmirësimi dhe përditësimi në përdorimin e platformës Online konsultime publike për	2019	5000	1500	5000	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM MAP	Platforma Online e përditësuar Udhëzuesi në internet i zhvilluar dhe përdorur nga institucionet shtetërore	Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit në platformën online për konsultimet me publikun ka filluar në vitin 2020, mirëpo sidomos 2022 ka punuar në përditësimin e të dhënave për institucionet e edhe për koordinatorët përgjatë gjithë kohës së pandemisë si dhe ndryshimit të vendimeve të Kuvendit për institucionet qeveritare, korigjimin e platformës dhe mirëmbajtjen e saj me të dhëna të reja. Gjatë vitit 2022 jemi fokusuar në zbatimin të standardeve minimale për konsultimet me publikun dhe kemi arritur të avancojmë Platformën e Konsultimeve Publike https://konsultimet.rks-gov.net ; duke shtuar funksionalitete të reja dhe duke përmirësuar qasjen për qytetarët dhe shoqërinë civile për pjesëmarrje në proceset konsultative në lidhje

									<p>me dokumentet që hartohen nga institucionet qendrore dhe lokale. Kemi ofruar pasqyrë të qartë të performancës së institucioneve për përfshirje të qytetarëve dhe shoqërisë civile në politikë bërje. Gjatë periudhës 01 janar deri me 31 dhjetor 2022 për publikun në konsultim publik në platformën për konsultime https://konsultimet.rks-gov.net</p> <p>Sipas statistikave të nxjerra për periudhën që po raportohet janar- dhjetor 2022, janë publikuar 248 dokumente. Prej 248 dokumenteve janë: 25 koncept dokumente, 46 draft ligje, 17 strategji, 05 programe, 04 plane veprimi, 47 draft rregullore, 100 udhëzime administrative dhe 04 dokumentet tjera.</p> <p>Si koordinatorë e procesit të konsultimeve me publikun në bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës përmes koordinatorëve për konsultime në ministritë e linjës kemi arritur të avancojmë Platformën për Konsultimet me Publikun https://konsultimet.rks-gov.net duke shtuar funksionalitete të reja dhe duke e përmirësuar qasjen për qytetarët dhe shoqërinë civile për pjesëmarrje në proceset konsultative në lidhje me dokumentet që hartohen nga institucionet qendrore dhe lokale.</p> <p>Në platformën online për konsultimet me publikun është punuar në përditësimin e të dhënave për institucionet e edhe për koordinatorët përgjatë gjithë kohës, korrigjimin</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

									<p>e platformës dhe mirëmbajtjen e saj me të dhëna të reja. Numri i komenteve që kemi pranuar direkt në platformë gjatë vitit 2022 është 274 komente ku janë 50 dokumente janë të komentuara, ndërsa 198 nuk kanë komente. Duke e parë se po jetojmë në një shoqëri të transformuar nga teknologjia Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë kemi punuar dhe kemi prezantuar para publikut videon promovuese për qasje në platformën për konsultime me publikun edhe për personat me aftësi të kufizuara https://konsultimet.rks-gov.net</p> <p>Prej të gjitha dokumenteve të publikuara në platformë, pra prej 248 dokumenteve, 176 prej tyre ose 71% i plotësojnë standardet dhe 72 dokumente ose 29% prej tyre nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun.</p>
1.1.5	Ofrimi i trajnime në vend të punës për Ministritë e përzgjedhura në përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike	2019	2500	500	2000	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM MAPL, KIPA	Trajnim në vend të punës për 7 Ministri për përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike të ofruara	Edhe gjatë vitit 2022 Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit kanë vazhduar bashkëpunimi me ministritë, komunat dhe shoqërinë civile sa i përket mbarëvajtjes dhe përmirësimit të procesit të konsultimeve publike. Ministrive dhe jo vetëm, por edhe Komunave, ju është ofruar mbështetje e vazhdueshme nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë përmes informatave të përditshme, përgjigje dhe sqarime siç është kërkuar nga ata.

1.1.6	Organizimi i sesioneve praktike trajnimi për përdorimin efektiv të Platformës Online	2019/2020	3000	1000	1000	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM Projekti i AT	5 seanca trajnimi me Ministrinë dhe Komunitet	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me Institutin e Administratës Publike –IKAP, ka realizuar trajnim për ngritje të kapaciteteve të shërbyesve civile nga niveli qendror e lokal për konsultimet me publikun dhe platformën online për përfshirje në politikë bërje. Për të vazhduar bashkë me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ku janë ftuar nëpunës të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal që të marrin pjesë në trajnimin online: Nga të dhënat dhe informatat e pranuar nga IKAP-i pjesë e procesit të trajnimeve për nivel qendror dhe lokal kanë qenë 48 zyrtarë nga niveli qendror e lokal.
-------	--	-----------	------	------	------	-----------------------	-----------------------	---	--

1.7	Organizimi i takimeve koordinuese të Ministrive dhe Zyrave të ZKM-ve	2019	Kosto administrative	Kosto administrative		ZQM/ZKM MAPL	6 takime të organizuara	Në vazhdimësi! Aktiviteti edhe pse i planifikuar me 2019, bazuar në Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Konsultime me Publikun, por bazuar edhe në praktikën tonë të përditshme në si zyrë bashkë me koordinatorët për konsultime në ZKM dhe Ministrinë e Linjës koordinojmë dhe monitorojmë rrjedhën e procesit të konsultimeve me publikun. Me përkrahjen e projektit TACSO-s nga KE ne kemi punuar në përditësimin dhe përmirësimet në platformën online andaj me 21 korrik 2021 kemi realizuar takim të përbashkët me koordinatorët për konsultime në ministri . Në këtë takim ne i kemi prezantuar përditësimet dhe përmirësimet që janë bërë në platformë. Gjatë vitit të fundit sipas vendimeve të kuvendit kanë ndodhur ndryshime institucionale, e kjo automatikisht ka sjellë edhe ndryshime në strukturën e koordinatorëve dhe në platformë. Ne si administrator të platformës i kemi realizuar ndryshimet dhe përditësimet sipas këtyre vendimeve, dhe të njëjtat ndryshime i kemi komunikuar me të gjithë koordinatorët.	
1.1.8	Publikimi i raporteve vjetore të monitorimit për përputhshmëria	2020	1500	1500	1500	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM MAPL Ministrinë e linjës, komunat	Raportet vjetore të monitorimit të publikuara në kohë dhe	Në vazhdimësi! Në pajtim me Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Konsultimet me Publikun, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit udhëheqë dhe është përgjegjëse

	me standardet minimale për konsultime publike në nivelin qendror dhe lokal							në përputhje me kërkesat e Rregullores	për hartimin e Raportit Vjetor për Konsultimet Publike të zhvilluara nga të gjitha ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit. Në përputhje me kërkesat e Rregullores, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me të gjitha ministrinë dhe institucionet tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit për të katërtin vit me radhë ka përgatitur raportet vjetore për konsultimet me publikun. Kërkesës së Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit për raportim nga ana e ministrive të dërguar me datë 22 shkurt 2022 i janë përgjigjur 14 ministri prej 15 sa janë, si dhe zyrat përgjegjëse në Zyrën e Kryeministrit.
1.1.9	Publikimi i praktikave më të mira të konsultimit me institucionet qendrore dhe komunat	2019	1000	1000	1000	Buxheti i Kosovës	ZQM/ZKM MAPL Ministrinë, Komunat	Praktikat më të mira të mbledhura, publikuara dhe promovuar në institucionet qendrore dhe lokale.	MAPL në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ka themeluar 'Forumit Konsultativ për Qeverisje Lokale' me qëllim të involvimit të tyre në politikat publike. Gjatë takimeve me organizatat e shoqërisë civile janë diskutuar edhe temat rreth praktikave më të mira të konsultimit publik në nivel qendror dhe lokal. Për më shumë shih: https://mapl.rks-gov.net/forumi-konsultativ-per-qeverisje-lokale/
1.1.10	Rekrutimi i një zyrtari të ri për të koordinuar procesin e	2020		6000	6000	Buxheti i Kosovës	MF MAPL ZQM/ZKM	Zyrtari i rekrutuar dhe duke punuar	Gjatë kësaj kohe dhe në periudha të shkurta ZQM/ZKM është përkrahur nga projekte dhe donatorët e ndryshëm, projekti TACSO.

	konsultimit publik								
1.2	Objektivi Specifik: Ngritja e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet me publikun								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	
			2019	2020	2021				
1.2.1	Zhvillimi i një strategjie komunikimi publik në platformën online dhe standardet e konsultimeve publike	2019	1000	1000	0	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM Projekti i AT	Strategjia e komunikimit është zhvilluar, publikuar dhe plotësisht funksionues e	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit prej vitit 2020 e deri tash ka filluar e po vazhdon fushatën informuese për Platformën Online për Konsultimet me Publikun dhe Standardet minimale për përfshirje të qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Është përgatitur edhe një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultime Publike. Përmes kësaj fushate iu ka bërë thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që ta shfrytëzojnë Platformën Online për konsultimet me publikun, pasi që kjo është mënyra më e thjeshtë dhe më e shpejtë për të ndikuar drejtpërdrejt në tërë legjislacionin e përgatitur nga Qeveria e Kosovës për miratim në Kuvendin e Kosovës. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me këtë fushatë ka synuar vetëdijesimin e publikut për rëndësinë e shfrytëzimit efektiv të Platformës Online për Konsultime Publike, forcimin, qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit të konsultimeve publike dhe ç'është më

									e rëndësishmja përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e politikë bërjes dhe vendimmarrjes.
1.2.2	Zhvillimi i një fushate të ndërgjegjësimit mbi standardet e konsultimeve publike	2019/2020	0	1500	0	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM Projekti i AT	Udhëzimi i përdorimit të platformës online për konsultim publik nga OShC-të dhe qytetarët e zhvilluar dhe duke u shfrytëzuar	Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit duke filluar nga shtatori 2020 e deri në vitin 2022 ka avancuar modalitetet në platformën për konsultime dhe përmes platformës, uebfaqes dhe rrjeteve sociale, ka zhvilluar dhe po zhvillon një fushatë informuese për Platformën Online për Konsultimet Publike dhe Standardet Minimale për përfshirjen e qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Është përgatitur një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultimet Publike (tutorial) i cili u bën thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që të përdorin Platformën Online për konsultime publike. Ky tutorial gjithashtu edhe e shpjegon se si shoqëria civile dhe publiku mund të përfshihen në platformë dhe të komentojnë. Kjo fushatë synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e përdorimit efektiv të Platformës Online për Konsultimet Publike, mbi forcimin, qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit të konsultimit publik dhe më e rëndësishmja përfshirjen e shoqërisë civile në politikë bërjen dhe vendimmarrje.
		2019	2000	2000	2000	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM MAPL Projekti i AT	3 Video në platformën Online të transmetuar në TV kryesore dhe radio stacione, si dhe përmes rrjeteve sociale	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit është duke e vazhduar fushatën informuese për Platformën Online për Konsultimet me Publikun
		2019-2020	1000	0	0	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM	Dizajnimi, shtypja dhe shpërndarja e broshurave për	

								<p>platformën online</p> <p>dhe Standardet minimale për përfshirje të qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit e ka përgatitur edhe një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultime Publike, ku iu bën thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që ta shfrytëzojnë Platformën Online për konsultimet me publikun, pasi që kjo është mënyra më e thjeshtë dhe më e shpejtë për të ndikuar drejtpërdrejt në tërë legjisllacionin e përgatitur nga Qeveria e Kosovës për miratim në Kuvendin e Kosovës.</p> <p>Me këtë fushatë është duke e synuar vetëdijesimi i publikut për rëndësinë e shfrytëzimit efektiv të Platformës Online për Konsultime Publike, forcimin, qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit të konsultimeve publike dhe ç’ është më e rëndësishmja përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e politikë bërjes dhe vendimmarrjes.</p> <p>Falë komenteve nga qytetarët dhe shoqëria civile deri më tani janë pasuruar dhe përmirësuar dhjetëra ligje dhe rregullore përpara dorëzimit të tyre për miratim nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky aktivitet është përkrahur nga Projekti i Asistencës Teknike të BE-së - “Mbështetje për Implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile”.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

1.3	Objektivi Specifik: Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	
1.3.1	Mbajtja e sesioneve informuese në rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike	2020	2000	2000	2000	ZQM/ZKM M Donator ët	ZQM/ZKM/ KIPA Projekti i AT	Sesione informimi të mbajtura për 3 grupe të OSHC-ve	Edhe pse Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka organizuar dhe realizuar takime edhe me OJQ-të për ti informuar për procesin e konsultimeve me publikun, platformën për konsultime dhe detajet për qasje në platformë, ajo që duhet të theksohet është se gjatë kohës që po raportohet nuk janë realizuar trajnime e sesione informues vetëm për OJQ-të për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike.
2	OBJEKTIVA STRATEGJIKE II Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik								
2.1	Objektivi Specifik: Fuqizimi i kapaciteteve të ministrive dhe komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OJQ-ve								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	Progresi i zbatimit (Plotësohet nga Institucioni zbatues)
			2019	2020	2021				

2.1.1	Kryerja e trajnimit për zbatimin e Rregullores dhe vlerësimin e propozimeve të projekteve dhe programit të OShC-ve për ministritë dhe komunat	2019-2021	4000	4000	4000	Buxheti i Kosovës Donatorët	MF ZQM/ZKM, MAPL, Projekti i AT	Programi i trajnimit i zhvilluar dhe janë mbajtur sesione trajnimi dhe punëtori për vlerësimin e projekteve / programeve për organizatat e shoqërisë civile në nivelin qendror dhe lokal	<p>Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike dhe me përkrahjen e projektit të AT të BE-së, gjatë 2020, kanë organizuar dhe ofruar Programin e trajnimit të trajnerëve (ToT) për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Ky program është ofruar për zyrtarë të institucioneve publike dhe ka pasur synim të krijojnë një grup të trajnerëve që IKAP në të ardhmen do të mund të i angazhojë si trajner për ngritje kapacitetesh për zyrtarë tjerë në institucione publike në fushën e financimit publik të OJQ-ve. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike, pas procedurave të prezantimit nga pjesëmarrësit dhe vlerësimit nga Komisioni, kanë organizuar ceremoni për certifikim të trajnerëve (ToT) për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Me këtë rast janë certifikuar dymbëdhjetë (12) Trajner për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.</p> <p>Zyrtaret e departamenteve relevante në vazhdimësi kanë ndjekur trajnime të organizuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. Nga IKAP kemi të dhëna se pjesë e</p>
-------	---	-----------	------	------	------	-----------------------------	---------------------------------	--	---

									trajnimeve që ata i kanë realizuar kanë qenë 23 zyrtarë.
2.1.2	Ofrimi i trajnimit në vend të punës dhe mentorimi (përfshirë rolin mbikëqyrës) për ministritë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve dhe programeve të OShC-ve	2019 2021	2000	1500	1500	Buxheti i Kosovës, BE	MF ZQM/ZKM MAPL Projekti i AT	Trajnim në vendin e punës dhe mentorim i siguruar për të paktën 9 ministri dhe 15 komuna	Në vazhdimësi, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave kanë ofruar përkrahje e për institucionet publike, për ministritë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve dhe programeve të OShC-ve, raportimin dhe planifikimin të financimit publik të OJQ-ve.
2.1.3	Organizimi i takimeve koordinuese të ZKM-ve, ministrive dhe komunave për planifikimin dhe raportimin e përbashkët për financimin publik të OShC-ve	2019	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative		ZQM/ZKM MF, MAPL Projekti i AT	Të paktën 5 takime koordinuese të organizuara	Rregullorja MF-Nr. 04/2017 2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve, ka përcaktuar detyrimin dhe obligimet e të gjitha organizatave buxhetore për planifikim dhe raportim lidhur me fondet publike që ndahen për organizatat jo-qeveritare. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit menjëherë ka filluar me koordinimin e punës së këtij mekanizmi si dhe në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të caktuar në përputhje me rregulloren. Bashkë me projektin TACSO dhe ekspertë e angazhuar nga projekti me 09 dhe 10 dhjetor 2021 kemi realizuar sesione informuese

									<p>për zyrtarët të nivelit qendror e lokal për planifikimin dhe raportimin e financimit publik për OSHC-të. Aktiviteti dyditor shërbeu për të informuar koordinatorët e emëruar mbi detyrat e tyre si dhe për procedurën e decentralizuar të raportimit. Trajnimi përbëhej nga a) Përshkrimi i detyrimeve të koordinatorëve për zbatimin e Rregullores dhe b) Prezantimi i Platformës për financimin publik të organizatave joqeveritare. Këto pika kontakti janë caktuar me qëllim të koordinimit më të mirë të procesit të përgatitjes së Planit Vjetor të Financimit Publik të OJQ-ve dhe të Raportimit brenda vetë organizatave buxhetore dhe me Zyrën e Kryeministrit. Kjo synon përmbushjen e detyrimeve të Organizatave Buxhetore sipas kërkesave të Rregullores MF. Nr. 04/2017. Obligimet kryesore të Organizatave Buxhetore në drejtim të përgatitjes së Planit Vjetor për Financimin Publik të OJQ-ve dhe përgatitjes së Raportit Vjetor për financimin publik të OJQ-ve rrjedhin nga Rregullorja MF. Nr. 04/2017. Dispozitat e Rregullores përcaktojnë qartë obligimet ndaj komunave dhe ministrive për këto çështje, duke përfshirë edhe afatet kohore për përgatitjen e planit vjetor dhe raportit vjetor. Rregullorja parasheh obligimet e të gjitha organizatave buxhetore për planifikimin dhe raportimin vjetor lidhur me fondet publike të alokuara për organizatat joqeveritare në Kosovë.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>Ky mekanizëm po udhëhiqet nga ZQM/ZKM dhe rrjedhimisht pikat e kontakti (koordinatorët) do të jetë përgjegjëse për të koordinuar përgatitjen e planit dhe raportit vjetor të financimit publik të OJQ-ve, publikimin e tij dhe përcjelljen e raportit te Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit sipas afateve të parapara me rregulloren MF-Nr. 04/2017.</p> <p>Bazuar edhe në rekomandimet e Kuvendi të Republikës së Kosovës të miratuar me 04 tetor 2021, tashmë mekanizmi për Raportimin e mbështetjes së financimit publik për OJQ-të për zbatim të Rregullores MF-Nr. 4/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-v është krijuar në fillim të dhjetorit 2021 dhe ka raportuar direkt në platformën për financim të OJQ-ve. Gjithashtu koordinorët bashkë me ZQM/ZKM kanë publikuar edhe planin për financim për vitin 2022.</p>
2.1.4	Publikimi i raporteve vjetore për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë	2019 2020 2021	1000	1000	1000	Buxheti i Kosovës, BE, Donatorët	ZQM/ZKM MF, MAPL, Projekti i AT	Raporti vjetor i publikuar në kohë dhe në përputhje me kërkesat	<p>Në vazhdimësi</p> <p>Raporti për vitin 2022 është përgatitur dhe publikuar sipas rregullores ku secili ofrues i mbështetjes financiare dërgon raport te ZKM. Platforma e Financimit Publik i është nënshtrua një përmirësimi për të mundësuar raportimin hierarkik i administruar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe me shumë përdorues tjerë konkretisht nga të gjitha</p>

									<p>Ministritë dhe Komunitet e Kosovës si dhe njësitë përkatëse të tyre tashmë po raportojnë direkt në platformë.</p> <p>Platforma e Financimit Publik tani lehtëson raportimin e financimit publik me futjen e dyfishtë të të dhënave, p.sh. përmes raportimit të drejtpërdrejtë në platformën e secilit prej projekteve të financuara nga institucionet publike, ose raportimit masiv duke u mundësuar organeve publike të mbledhin të dhëna nga të gjitha nën njësite dhe të importojnë të dhënat përmes modulit të importit të platformës. Në anën e qasjes nga publiku të platformës, ka veçori të reja të filtrimit të të dhënave, si dhe grafikët ndërveprues që vizualizojnë të dhënat dhe ndihmojnë publikun të ketë një perceptim se si shpenzohen paratë publike nga secili prej institucioneve, përfituesit e OSHC-ve, territoret ku janë shpenzuar para dhe fushat dhe aktivitetet e përgjithshme të projekteve.</p> <p>Procesi i raportimit për financimin e OJQ-ve është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke e mundësuar edhe raportimin direkt në platformën për financim publik të OJQ-ve http://ojqfinancime.rks-gov.net</p> <p>Gjatë kësaj kohe kemi punuar në avancim të platformës, ku me një kërkim të lehtë në platformën online mund të gjinden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OSHC-të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

									sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, regjione, fushave etj. Për herë të parë këtë vit do ta realizojmë transparencën e plotë të shpenzimeve të buxhetit për sektorin e shoqërisë civile duke ofruar të gjitha të dhënat e procesit të shpenzimit të parasë publike për OJQ-të. Është punuar dhe arritur që raporti për vitin 2022 të përgatitet dhe publikohet direkt në platformë, pra të gjitha organizatat buxhetore do të raportojnë drejtpërdrejtë përmes platformës, duke ngarkuar të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve që i kanë përkrahur.
2.1.5	Përmirësimi i bazës së të dhënave qendrore online për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë ojqfinancime.rks-gov.net	2020	2500			Buxheti i Kosovës, BE, Donatorët	MF, ZQM/ZKM, MAP, Projekti i AT	Baza e të dhënave qendrore online për financimin publik të OSHC-ve është zhvilluar dhe plotësisht funksionale	Është përmirësuar baza së të dhënave qendrore online për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë Është krijuar transparencë dhe përgjegjshmëri më e madhe institucionale për ndarjen e fondeve publike për OSHC-të me zhvillimin dhe avancimin e Platformës Online për Financim Publik të OJQ-ve http://ojqfinancime.rks-gov.net/ Tash mund të gjinden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OSHC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, etj.
2.1.6	Rishikimi i Manualit për	2020		1500		Buxheti i Kosovës	MF, ZQM/ZKM, Projekti i AT	Manuali i rishikuar dhe azhurnuar	Në vitin 2023 do të iniciohet një rishikim i rregullores aktuale të financimit publik të OJQ-ve, për të adresuar pengesat kryesore të

	zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OShC-ve					s, BE, Donatorët		bazuar në reagimet nga ministritë dhe komunat.	identifikuara gjatë viteve të zbatimit të saj dhe bashkë me të do të rishikohet edhe manuali.
2.1.7	Rritja e rolit mbikëqyrës të MF në zbatimin e Rregullores	2019	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative		MF ZKM Projekti i AT	letër qarkore dërguar nga MF (Dep i Buxhetit) mbi zbatimin e Rregullores për ministritë dhe komunat	Departamenti i Buxhetit gjatë komunikimit me Organizata Buxhetore vazhdimisht kërkon të zbatohet Rregullorja për financimin e OJQ-ve.
2.1.8	Vendosja e bashkëpunimit dhe komunikimit midis OB dhe OSHC-së në lidhje me ciklin e financimit të OSHC-ve të financave publike (planifikimi, ekzekutimi dhe auditimi).	2020		3000	3000	Buxheti i Kosovës, Donatorët	MF, ZQM/ZKM Relevant Ministritë Komunat	Konsultimet publike për planin vjetor të thirrjeve publike nga niveli qendror dhe lokal për financimin e OSHC-ve të zbatuara përfshirë planifikimin, ekzekutimin	Është në vazhdimësi duke u përmirësuar sistemi i planifikimit dhe raportimit dhe auditimi i financimit publik të OJQ-ve. Platforma përveç që do të jetë një dritare për publikimin e planeve për financim të fondeve që institucionet ndajnë për OSHC-të, në fazën tjetër ajo mund dhe planifikohet të adaptohet dhe lidhet drejtpërdrejtë edhe me bazën e të dhënave të donatorëve ndërkombëtarë që financojnë OSHC-të në Kosovë, e cila aktualisht menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë. Kjo realisht është edhe kërkesën e Zyrës së BE-së.

									dhe monitorimin.	
2.2	Objektivi Specifik: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave									
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati		
			2019	2020	2021					
2.2.1	Rishikimi i kornizës ligjore të përcaktimit dhe rregullimit të filantropisë (përfshirë miratimin, harmonizimin e fushave të OBF)	2020	1000	2000		Donatorët	MF ZKM/ZL	Koncept dokumentet për krijimin e një kornize ligjore gjithëpërfshirëse për filantropinë në vend	Ndonëse, disa nisma fillestare janë ndërmarrë në nivelin e diskutimeve në vitin, nuk ka ndryshime në legjislacion në lidhje me filantropinë individuale dhe atë të korporatave. Nuk ka progres që duhet të vlerësohet. Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave është planifikuar që të zbatohet në bashkëpunim me ATK, FIQ dhe duhet të punohet gjatë viti 2023.	
2.2.2	Dizajnimi dhe realizimi i një programi të trajnimit / sistem për zyrtarët e taksave mbi praktikat lokale dhe ndërkombëtare të administrimit të përfitimeve	2021		2000	2000	Buxheti i Kosovës, Donatorët	MF ATK	Programi i trajnimit i projektuar dhe zhvilluar dhe janë realizuar sesione trajnimi	Nuk ka progres dhe rrjedhimisht në linjë të aktivitetit paraprak shtyhet për vitin tjetër.	

	tatimore për filantropinë individuale dhe të korporatave								
2.2.3	Krijimi dhe forcimi i mekanizmave institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave	2019		1000	1000	BE Buxheti i Kosovës, Donatorët	ATK, FIQ, Projekti i AT	Përcaktohen përgjegjësitë institucionale për monitorimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore dhe të politikave për filantropi Personeli përkatës nga institucionet përgjegjëse për politikën e filantropisë i trajnuar	Ky aktivitetet do të realizohen në vitin 2023. Nuk ka progres.
2.2.4	Prodhimi i broshurave për biznesin dhe qytetarët për mundësitë për dhurime individuale ose	2020		2000		Buxheti i Kosovës Donatorët	MF ZKM-ZQM Projekti i AT	Fletëpalosje të hartuara dhe të shtypura (1000 kopje) Fletëpalosje të shpërndara	Nuk ka progres.

	të korporatave për shoqërinë civile							për qytetarët dhe biznesin	
2.3	Objektivi Specifik: Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OShC-të								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	
			2019	2020	2021				
2.3.1	Vendosja e standardeve, procedurave, kriterëve dhe mekanizmave transparentë për rregullimin e alokimit të pronës shtetërore për përdorim nga OShC-të	2020		1500		Buxheti i Kosovës	MAPL Ministritë, Komunitat	Standardet dhe Procedurat e hartuara dhe të miratuara.	Është miratuar Ligji nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Rregullorja (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të cilat rregullojnë procedurat, kriteret si dhe mekanizmat transparentë për rregullimin e alokimit të pronës komunale për përdorim nga OShC-të.
2.3.2	Hartimi dhe shpërndarja e një programi trajnimi / sistemi për nëpunësit civilë mbi përdorimin e	2021			3000	Buxheti i Kosovës, Donatorët	MAPL, MAP, KIPA	Trajnim për zbatimin e standardeve dhe procedurave për shpërndarje	Pas miratimit të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Rregullorja (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës janë organizuar trajnime për të sqaruar

	standarde dhe procedurave për rregullimin e ndarjes së pronës publike për OShC-të.							n e pronës publike për OShC-të të hartuara dhe të zhvilluara	procedurat për dhënien e pronës komunale duke përfshirë edhe OShC-të. Gjithashtu është hartuar edhe një Qarkore ku u është shpërndarë komunave lidhur me procedurat e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim shkresë njoftuse për komuna lidhur me procedurat e kthimit të pronave të menxhuar nga AKP në pronësi të komunave.
2.2.3	Zhvillimi i Regjistrimit Elektronik të Pronave të Shtetit të alokuara për përdorim nga OShC-të	2021		5000			MAPL, MAP, ZKM	Regjistri elektronik i përgatitur dhe funksional	Ligji nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Rregullorja (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e kanë paraparë që komunat janë të obliguar që të publikojnë listen e pronave komunale që planifikojnë të ipen në shfrytëzim, kjo listë duhet të publikohet në faqen e komunës respektive.
2.4	Objektivi Specifik:Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të financuara nga BE-ja								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	
			2019	2020	2021				

2.4.1	Vendosja e një mekanizmi financimi në MIE për bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE për OShC-të	2020	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative		MIE ZKM	Mekanizmi i financimit është krijuar dhe është funksional	Nuk ka progres.
2.4.2	Vendosja e standardeve, procedurave dhe mekanizmave institucionalë të bashkëfinancimit të projekteve të financuara nga BE-të për OShC-të	2020	1500			Buxheti i Kosovës	MIE ZKM/ZQM	Analizë e praktikave të mira në bashkëfinancim të projekteve të OShC-ve të financuara nga BE, standardet dhe procedurat e përgatitura të miratuara dhe institucioni përgjegjës me buxhet adekuat	Zbatimi në zhvillim e sipër. Janë duke u realizuar diskutimet fillestare.
2.4.3	Dizajnimi dhe realizimi i një	2021			2000	Buxheti i	MIE ZKM	Program trajnimi i	Nuk ka progres.

	programi të trajnimit / sistem për nëpunësit civilë dhe OShC-të mbi përdorimin e standardeve dhe procedurave për bashkëfinancim të projekteve të financuara nga BE-të për OShC-të					Kosovës		dizajnuar dhe realizuar për stafin përkatës të institucioneve përgjegjëse	
2.4.4	Mbajtja e sesioneve të informimit për OShC-të për mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve të financuara nga BE	2021			3000	Buxheti i Kosovës	MIE ZKM/ZQM	5 seanca informuese të mbajtura në qendrat kryesore rajonale	Nuk ka progres.
2.4.5	Rekrutimi i një zyrtari të ri për koordinimin e procesit të financimit publik të OSHC-ve	2020		6000	6000	Buxheti i Kosovës	MF MAP ZQM/ZKM	Zyrtari i ri i rekrutuar dhe duke punuar	Është bërë transferimi i një zyrtari të ish-MIE te Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

3	Objektivi Strategjik: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;								
3.1	Objektivi Specifik: Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	Progresi i zbatimit (Plotësohet nga Institucioni zbatues)
			2019	2020	2021				
3.1.1	Konsolidimi i kornizës së përgjithshme ligjore, përfshirë legjislacionin tatimor, në lidhje me aktivitetet ekonomike të OSHC-ve	2020	1500	500		Buxheti i Kosovës, Donatorët	MF Ministritë e Administratave tatimore	Hartohet drafti i analizës së politikave mbi dispozitat që duhen adresuar, Korniza ligjore është konsoliduar (p.sh. Ligji për taksën e të ardhurave të korporatave) Kuadri ligjor është në zbatim	Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.
3.1.2	Përgatitja e Udhëzimeve për zbatimin e	2021			1500	Buxheti i Kosovës	MF Ministritë e linjës	Udhëzimet e përgatitura	Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim

	kornizës ligjore të konsoliduar me raste studimore					S, Donatorët	Administrata tatimore		
3.1.3	Organizimi i sesioneve informuese për nëpunësit civilë, përfshirë zyrtarët e taksave, për t'i informuar ata rreth kornizës ligjore të ndryshuar	2020		1000	500	Buxheti i Kosovës	MF Administrata tatimore, MAP	Mbajtja e 3 sesioneve informative	Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.
3.2	Objektivi Specifik: Përmirësimi i njohurive të institucioneve rreth mundësive ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	
			2019	2020	2021				
3.2.1	Finalizimi i vlerësimit të nevojave për ofrimin e	2020	3000	2000		Buxheti i Kosovës,	ZKM Të gjitha Ministrinë e	Vlerësimi i nevojave është formuluar	Aktualisht MFPT njihet si institucion që i mbështet OSHC-të në ofrimin e shërbimeve. Pika e nisjes, krahas nevojës për përmirësimin e

	shërbimeve publike nga OSHC-të në fusha të ndryshme					Projekti i AT	linjës, Komunat	për të vendosur standarde dhe procedura për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të	<p>mëtejme të legjislacionit, duhet të jetë krijimi i bazës së të dhënave për OSHC-të të cilat janë ofruese të shërbimeve. Kjo praktikë është krijuar kryesisht në kuadër të MFPT, MSH por prapë siç edhe është theksuar në këtë objektiv specifik, nevojiten përmirësime në legjislacion që duhet t'i rregullojnë standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve, si dhe për ngritjen e vetëdijes së institucioneve për modelet më të mira për kontraktimin e OSHC-ve.</p> <p>Gjithashtu Civikos është në proces te finalizimit te vlerësimit te nevojave te organizatave qe ofrojnë shërbime ne kuadër te projektit "Mitigating the impact of the COVID-19 pandemic on CSOs providing services mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, financuar nga German Marshall Fund -USAID.</p> <p>Në kuadër të projektit "Zbutja e Ndikimit të Pandemisë COVID-19 tek OSHC-të që Ofrojnë Shërbime në Kosovë", Platforma Civikos në partneritet me Zyrën për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit organizuan punëtorinë me Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri.</p> <p>Kjo punëtori synon që të vendosë bazat e rekomandimit të politikave për rregullimin e një sistemi të qëndrueshëm të kontraktimit të shërbimeve në Kosovë. CiviKos së bashku me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe akterë tjerë do të punojnë së bashku për</p>
--	---	--	--	--	--	------------------	--------------------	--	---

									<p>rregullimin e bazës ligjore për kontraktimin e shërbimeve për OSHC-të në Kosovë.</p> <p>Për vlerësim të nevojave të ministrive CiviKos do të përkrah Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ZQM/ZKM dhe institucionet tjera për finalizim të vlerësimit nga ana e institucioneve.</p> <p>Sidoqoftë, çështja e shërbimeve publike duhet të zhvillohet në të ardhmen.</p> <p>Për realizimin e këtij aktiviteti janë përgatitur në bashkëpunim dhe përkrahje të CiviKos-it për Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën Kryeministrit në realizim të masave dhe aktiviteteve në kuadër të Objektivës së Tretë dy raportet “Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike” të Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile dhe “Raportit të hartëzimit të organizatave që ofrojnë Shërbime në Kosovë” dhe “Raportit të hartëzimit të legjislacionit për kontraktim të shërbimeve”</p>
3.2.2	Dizajnimi dhe realizimi e një programi trajnimi për nëpunësit civilë për të mësuar rreth kornizës ligjore dhe		2000	5000	3000	Buxheti i Kosovës, Projekti i AT	ZKM Të gjitha Ministrinë e linjës, Komunitat	Trajnim i hartuar dhe ofruar për kornizën ligjore dhe modelet e disponuesh me për	Ky aktivitet ndërlidhet me ndryshimin e legjislacionit.

	modeleve të disponueshme për OShC kontraktuese në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike							OShC-të kontraktues e, 6 sesione trajnimi të mbajtura për OShC-të kontraktues e	
3.2.3	Fillimi i një fushate të informimit publik për të informuar OShC-të rreth mundësive për të ndihmuar qeverinë të ofrojë shërbime publike	2019 2020		1000	2000	Buxheti i Kosovës, Projekti i AT	ZKM Të gjitha Ministrinë e linjës	Fushata e informimit publik e përgatitur, 8 sesione të informimit publik të organizuara	Zyra për Qeverisje të Mirë ka qenë pjesë e aktivitetit që Fondi për Zhvillim Komunitar – CDF, në kuadër të Programit të financuar nga granti i Fondit Global kanë iniciuar diskutimin dhe procesin e krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të financimit publik të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), për të ofruar shërbime shëndetësore parandaluese të bazuara në komunitet, në kuadër të Programeve kombëtare për HIV dhe TB. Kontraktimi social është mekanizëm i financimit publik të OShC-ve i cili konsiderohet si faktor esencial në reagimin e qëndrueshëm dhe efektiv ndaj HIV dhe TB, dhe dëshmon kapacitetin e Qeverisë për të siguruar vazhdimësinë e zbatimit të këtyre shërbimeve të ofruara nga OShC-të edhe pas tranzicionit nga mbështetja financiare e donatorëve.

3-3										Objektivi Specifik: Mbledhja dhe publikimi i informatave mbi potencialin e OSHC-ve për të ofruar shërbime publike për institucionet publike									
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i finansi mit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati											
			2019	2020	2021														
3.3.1	Krijimi i një baze të dhëne me të gjitha informacionet e nevojshme për OShC-të që ofrojnë shërbime publike dhe OSHC-të potenciale që mund të bëhen ofrues të shërbimeve publike	2019/2020	5000	1000	15000	Buxheti i Kosovës, Donatorët	ZKM, Të gjitha Ministrinë	Dizajnimi i bazës së të dhënave e përfunduar Baza e të dhënave e lansuar. Të gjitha OShC-të janë regjistruar si ofrues të mundshëm të shërbimeve publike	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve posedon një liste të OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale. Po ashtu Ministria e Shëndetësisë ka një liste të OJQ-ve që ofrojnë shërbime shëndetësore Ish MPMS, tanimë Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, disponon dhe ka në dispozicion listën e OJQ-ve të licencuara për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel vendi. Nr. i OJQ-ve të licencuara ka arritur në 49 OJQ. Gjithashtu Civikos është në proces të grumbullimit të dhënave për OSHC-te që ofrojnë shërbime.										
3-4										Objektivi Specifik: Përmirësimi i legjislacionit që rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të									
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i finansi mit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati											
			2019	2020	2021														

3.4.1	Krijimi i standardeve, procedurave dhe kriterëve për rregullimin e ofrimit të shërbimeve publike nga OShC-të	2021	1000	4000		Donatorët	ZKM Të gjitha ministrinë përkatëse	Standardet dhe Procedurat e hartuara dhe të miratuara.	Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.
3.4.2.	Përgatitja e një manuali online me udhëzime për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike, bazuar në kornizën ligjore të ndryshuar				5000	Donatorët	ZKM Të gjitha ministrinë përkatëse	Manual me udhëzime për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimit publik të përgatitur dhe shpërndarë, bazuar në kornizën ligjore të ndryshuar Manual publikuar në internet	Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.
4.	Objektivi Strategjik IV 'Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik'								

4.1 Objektivi Specifik: Vendosija e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale për të mbështetur zhvillimin e vullnetarizmit									
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	
			2019	2020	2021				
4.1.1	Hartimi dhe miratimi i projekt-koncept dokumentit për vullnetarizmin	2020	2000	1000	0	Buxheti i Kosovës Donatorët	ZKM MF Projekti i AT	Koncept dokumenti për rregullimin dhe promovimin e vullnetarizmit i përgatitur, Rekomandimet e koncept dokumentit për vullnetarizmin dhe masat e tjera të nevojshme të miratuara Rekomandimet e koncept dokumentit të miratuar	<p>Koncept Dokumentit për Vullnetarizëm është në proces të finalizimit dhe tashmë është duke u punuar në përmbylljen e tij. Ky proces u diskutua edhe me rastin e ditës së Rinisë në korrik dhe bashkë me OJQ-të pjesëmarrëse jemi pajtuar që ky draft të jetë sa më shpejt për konsultim paraprak dhe publik. Për të kontribuar në proces të finalizimit të Koncept Dokumentit për Vullnetarizëm, drafti është ndarë me OJQ-të që punojnë në fushën e vullnetarizmit. Bashkë me partner jemi në përmbyllje të dokumentit dhe shumë shpejt do të procedohet për konsultim paraprak e publik dhe aprovim në qeveri.</p> <p>ZQM/ZKM bashkë me Ekipin e katërt të Këshillit për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile dhe MKRS është duke finalizuar Koncept Dokumentit për Vullnetarizëm.</p>

								duke siguruar zbatimin solid të ligjit	
4.1.2	Implementimi i rekomandimeve nga Koncepti dokumenti	2021			5000	Buxheti i Kosovës Donatorët	ZKM MF	Rekomandi me dokumentin Koncept për rregullimin dhe promovimin e vullnetarizmit të përgatitura Rekomandi me Konceptin dokumentit	Koncepti dokumenti duhet të finalizohet me ekipin dhe ky aktivitet realizohet në rrjedhë të aktivitetit paraprak dhe duhet të shtyhet për 2023
4.2	Objektivi specifik: Zhvillimi i kapaciteteve të OShC-ve për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët								
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	Progresi i zbatimit (Plotësohet nga Institucioni zbatues)
			2019	2020	2021				
4.2.1	Lansimi i një skeme grante për financimin e aktiviteteve për	2021			20.000	Donatorët Buxheti i	ZKM MKRS, MPMS, MF	Skema e Grantëve e publikuar dhe 4-5 OSHC të	Nuk është realizuar

	ndërtimin e aftësive për OShC-të në menaxhimin efektiv të vullnetarëve					Kosovës		kontraktuara për të ofruar programe trajnimi mbi menaxhimin efektiv të vullnetarëve në komunitetet e tyre lokale Ligjet e nevojshme të ndryshuara; Gazetë zyrtare; faqet e internetit të ZQM-ZKM; raporte mbi zbatimin e strategjisë	
4.2.2	Përgatitja e një manuali me udhëzime për rekrutimin dhe menaxhimin e vullnetarëve	2021	5.000			Donatorët,	ZKM Të gjitha ministrinë përkatëse	Manual me udhëzime për angazhimin e vullnetarëve të përgatitur dhe shpërndarë,	Nuk është realizuar

								bazuar në kornizën ligjore të ndryshuar Manuali i publikuar në faqen e internetit të ZKM-ZQM	
4.3 Objektivi specifik: Rritja e ndërgjegjësimit qytetar në mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit									
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Rezultati	Progresi i zbatimit (Plotësohet nga Institucioni zbatues)
			2019	2020	2021				
4.3.1	Realizimi i një fushate ndërgjegjësimi për vullnetarizmin dhe rolin e saj në përmirësimin e mirëqenies publike	2021			7000	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM Projekti i AT, Ministrisë e linjës	Video spot mbi rëndësinë e vullnetarizmit i përgatitur dhe transmetuar. Fletëpalosje se si mund të organizohet vullnetarizmi i përgatitur dhe shpërndarë.	Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë kanë organizuar takim të përbashkët me zyrën dhe konferencë për media bashkë me OJT-të që punojnë me të rinjtë dhe ata që merren me vullnetarizmin . Zyra për Qeverisje të Mirë –Zyra e Kryeministrit së bashku me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe organizatat; PEN - Peer Educators Netëork / Lens / OSCE Mission in Kosovo/UNICEF/ RYCO/ kanë organizuar konferencë me rastin e Ditës Botërore të Vullnetarizmit me 05 dhjetor . Me këtë rast kanë qenë pjesë e fushatës së promovimit të vullnetarizmit në vend.

4.3.2	Përditësimi i regjistrit Online me vullnetarë të rinj të regjistruar			3000	2000	Buxheti i Kosovës, BE	ZQM/ZKM MKRS MAP, ZQM	Regjistri online i azhurnuar dhe i përdorur plotësisht	Për nder të Ditës së Rinisë, Lensi, mbështetur nga OSCE Mission in Kosovo dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ZQM/ZKM kanë prezantuar Platformën Kosovo Youth. Synim i kësaj platforme është punë, punë praktike, trajnime, bursa, grante, dhe shumë mundësi të tjera, të gjitha në një platformë të vetme.
-------	--	--	--	------	------	-----------------------	-----------------------------	--	---